



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar:		19.08 2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	052/01	39624	

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I

KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE



DRENAS
2021

PËRMBAJTJA

1.	ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS	3
1.1.	ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN.....	3
1.2.	ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM.....	3
1.3.	ZYRA E PERSONELIT	4
1.4.	ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE).....	5
1.5.	ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	6
1.6.	ZYRA PËR BARAZI GJINORE.....	7
2.	RAPORTET SIPAS DREJTORIVE	8
2.1.	DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....	8
2.2.	DREJTORIA E ARSIMIT	13
2.3.	DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	19
2.4.	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)	25
2.5.	DREJTORIA E INSPEKSIONIT	31
2.6.	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	34
2.7.	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	37
2.8.	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	45
2.9.	DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	58
2.10.	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË	67
2.11.	INFRASTRUKTURA PUBLIKE	71
2.12.	DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	73

1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2021 të kryetarit, janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 1116 lëndë të ndryshme dhe të gjitha janë procesuar me kohë, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerr 130 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës. Zyra e kryetarit ka organizuar një (1) takim me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Po ashtu janë mbajtur gjashtë (6) dëgjime për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasit. Po ashtu janë mbajtur edhe 3 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), janë mbajtur edhe 25 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor në baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si dhe janë diskutuar tema të ndryshme. Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook.

1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, ueb faqes së Komunës, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 350 komunikata të karakterit të ndryshëm. Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe me delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese janë pranuar 10 kërkesa për qasje dhe të gjitha kanë qenë të qasshme. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare. Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit.

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e përbërë prej dy auditorëve, Drejtorin e Njesisë dhe një Auditor. Kërkesat ligjore janë që ne të kemi së paku edhe një auditor për shkak të buxhetit mbi 15 milion dhe për shkak të numrit të personelit 1.325 mirëpo në mungesë të masës buxhetore për paga dhe në mungesë të numrit të certifikuar për punëtorë të rinjë, nuk kemi pasur mundësi që ta rrisim numrin e auditorëve. Si rezultat i ndryshimit të legjislacionit për rekrutim, në administratën komunale që nga viti 2019 nuk është lejuar rekrutimi. Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2020, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2021 -2023 si dhe duke u bazuar në këtë Plan, ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2021. Me Planin e Punës së kësaj Njësie, për vitin 2021 janë paraparë që të kryhen gjithësej shtatë auditime të rregullta. Deri me 30.06.2021 janë finalizuar katër Raporte të auditimit për Auditimet e kryera sipas Planit të Punës. Auditimet e planifikuara dhe të kryera kanë pasur për qëllim që të arrihen objektivat kryesore si:

- Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e komunës;

- Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane në dispozicion të komunës;
- Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- Rritja e vlerës së burimeve humane dhe materiale; dhe
- Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik.

Të gjitha raportet e finalizuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe janë nxjerrur konkluzionet për hapat që duhet të ndermirren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit. Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka qenë mjaft aktiv gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Deri me tani janë mbajtur gjithsej tri takime të këtij Komiteti ku janë shqyrtuar dhe aprovuar Planet Strategjike të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, raportet e finalizuar për auditimet e kryera nga kjo njësi, si dhe Raportet periodike tremujore për aktivitetet audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Gjatë këtij gjashtëmujori, Njësia e Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit ka qenë e monitoruar edhe nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, ku në të gjitha çështjet e monitoruara ka dalur se është në pajtueshmëri të plotë me të gjitha standardet e parapara në Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale në fushën e Auditimit. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është raportuar në baza gjashtëmujore tek Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrur një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës. Situata e përgjithshme me pandeminë Covid-19 ka ndikuar në vështirësimin e kryerjes së aktiviteteve të planifikuara për shkak të kufizimeve dhe mungesës së herë pas hershme të stafit, mirëpo deri më tani kjo Njësi është në përputhje me aktivitetet e planifikuara në fillim të vitit. Gjatë auditimeve janë zhvilluar intervista me menaxherët dhe ka shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrur në këtë drejtim. Fushat e audituara gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë:

1. Menaxhimi me kontratat e prokurimit;
2. Menaxhimi me pasuritë e Komunës të krijuara nga investimet kapitale dhe pasuritë tjera të lëvizshme kapitale jo financiare
3. Menaxhimi me personel në sektorin e Arsimit, dhe
4. Auditimi i proceseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga participimi dhe menaxhimi i përgjithshëm në QEAP.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë gjithsej 23 rekomandime dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrur një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre. Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrur gjithsej 29 aktivitete konkrete për jetësimin e rekomandimeve dhe edhe përkundër kohës së shkurtër, mbi 70 % të rekomandimeve janë implementuar dhe një numër i rekomandimeve të cilat janë dhënë në kohën e fundit janë në proces të adresimit të tyre. Ne inkurajojmë Drejtoritë dhe sektorët që edhe më tutje të shtojnë aktivitetet e tyre për jetësimin e rekomandimeve që janë në proces të implementimit. Gjithashtu falënderojmë menaxherët të cilët kanë arritur që të implementojnë rekomandimet e dhëna deri më tani.

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Për gjashtëmujorin e vitit 2021, Zyra e personelit ka azhuruar listatat e pagave sipas ndryshimeve, konformë zhvillimeve në stafin e punëtorëve. Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave;

Muaji-viti	Punëtorë i ri	Ndryshi me	Punëtorë të larguar	Pagesa retroaktiv	etj
------------	---------------	------------	---------------------	-------------------	-----

Janar 2021	1 (një) punëtor i ri	2	0	8	Lista për anët.dhe anët. të KK
Shkurt 2021	0	0	0	5	Lista për anët.dhe anët. të KK
Mars 2021		5	1 pensionim	5	Lista për anët.dhe anët. të KK
Prill 2021	1	6	1 (pensionim dhe 1 masë disiplinore	8	Lista për anët.dhe anët. të KK
Maj 2021	3	6	1	15	Lista për anët.dhe anët. të KK
Qershor 2021	0	5	1	9	Lista për anët.dhe anët. të KK

Nga muaji Janar 2021, zyra e personelit me kërkesë të MAP, USAID, IKAP, ATK, ka përgatitur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Është përgatitur lista e të dhënave të të punësuarave në shërbimin civil, për staf në arsim, në shëndetësi, staf politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore). Hartimi i planit individual i personelit për pozitat e lira nga të gjitha format e kërkesave për vitin 2020 është përfunduar në fund të muajit Dhjetor 2020, përmes sistemit të SIMBNJ, si dhe në Janar 2021 bëhet plotësim-ndryshimi i PPI, sipas kërkesës së DASHC që të përfshihen edhe pozitat e lira nga sektori i arsimit dhe shëndetësisë. Edhe pse ishim të interesuar sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitat e lira të punës që ishte edhe kërkesë imediate e njësive kërkuese për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me vdekjen e nëpunësit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitat e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2020 të cilat në mungesë të infrastrukturës ligjore (plotësim-ndryshimet ligjore dhe akteve nënligjore) në nivel vendi nuk ka pasur mundësi të realizohen. Sqarim; pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaji Janar 2021 është filluar me konkurse të mbyllura (brendshme) lëvizje paralele brenda kategorisë.

Në muajin Maj 2021, Auditorët e jashtëm - Kërkesa; dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt Emërimi, lista e pagave për muaj të caktuar, kualifikimi (diplomë ose çertifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë 2020, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndryshme mujore. Zyra e personelit është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me rastet ankimore. Po ashtu zyra e Personelit dhe njësia e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.11/2020 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore, për pagë jubilarë.

1.4. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE- Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integrimeve evropiane, ofron përkrahje, këshilla dhe ekspertizë profesionale drejtuesve në fushën e integrimit evropian duke marrë parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integrimit evropian dhe marrëdhëniet në Kosovë, siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioritetëve dhe planeve të institucionit, koordinon dhe konsultohet me institucionet përgjegjëse dhe me institucionet e tjera të jashtme përkatëse për fushën e integrimeve evropiane me qëllim të harmonizimit të prioritetëve dhe politikave, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të ministrisë në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare për integrim evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapacitetit të stafit për çështjet e ndërlidhura me integrim evropian, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët të njësive organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integrimit evropian, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës

monitoron produktet. ZKIE gjatë periudhës Janar –Qershor 2021 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimit të detyrave të punës dhe Rregullores Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokument ligjërsh i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe Komuna, ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimit të obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi përcjellë raporte sipas kërkesës së Ministrisë për Integritet Evropiane, kemi koordinuar punën me Drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve dhe Udhëheqësin e personelit për identifikimin e nevojave për trajnime për stafin civil të Komunës së Drenasit. Është raportuar me kohë kryetarit dhe MPL-së për Përbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2021 për Komunën e Drenasit. Në muajin Korrik është bërë përpilimi i Raportit të Përbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane dhe është përcjellë për Ministrinë e Integritet Evropiane përkatësisht znj. Edona Morina. Në këtë raport janë të përfshira të dhëna lidhur me Zyrën për Integritet Evropiane si dhe mbi përbushjen e obligimeve të Komunave të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar - Qershor 2021.

1.5. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë këtij gjashtë (6) mujori vitit 2021, ka pasur për fokus personat e riatdhesuar – riintegrimin e tyre. Gjatë këtij gjashtë mujori kemi 3 persona të riatdhesuar, të tre këto raste i kemi raste të cënueshme. Gjatë vitit 2020 kemi 1 (një) familje të cilët janë përfshirë në Asistencë Sociale. Në bazë të Rregullores së Riintegritit 22/2020, personat e riatdhesuar kanë mundësi aplikimi në: Vetëpunësim, Subvencionimi në punësim dhe Trajnim në punë. Tek subvencionimi dhe trajnimi në punë kemi pasur persona të cilët kanë aplikuar. Perfitues nga kjo skemë i kemi 5 persona. Gjatë këtij gjashtë mujori kemi pasur 20 kërkesa nga personat e riatdhesuar për paisje me vërtetim, pastaj për kompletim të dokumentacionit, ku të gjithë janë paisur në bazë të dokumenteve të kthimit që i kanë poseduar. Nga personat e riatdhesuar kemi verifikuar në teren 3 rastet e cënueshme. Verifikimi është bërë së bashku me kordinatorin rajonal nga MPB. Zyra për Komunitete dhe Kthim për këtë 6 mujor ka mbajtur 4 takime të Komiteti për Komunitete, ku temë diskutimi ka qenë gjithmonë si pike e pare Raporti i punës nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, pastaj temat të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës sonë. Gjithashtu kemi qenë pjesë e KKS-së, ku në çdo mbledhje kemi dhënë kontributin tonë.

Në fillim të muajit Mars kemi mbajtur takim me KFOR-Italian , ku kemi diskutuar për punën e ZKKK gjatë vitit 2020 dhe fillimin e vitit 2021. Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë këtij gjashtë (6) mujori ka vazhduar me monitorimin dhe bashkëpunimin me Organizatën “AKTI”, mbi projektin për përgatitjen e të rinjve dhe shfaqjen e vlerave të tyre, përmes trajnimit dhe këshillimit se bashku me trajnerët e tyre. Si koordinator e Grupit lokal të Veprimit – kemi mbajtur 3 mbledhje, ku si grup kemi diskutuar mbi punën dhe të arriturat e OJQ Akti , mbi të arriturat e të rinjëve të Komunës sonë. Në vazhdim të raportit paraqes punën e grupit dhe të Org. mbi aftësimin e të rinjve- grupeve të marginalizuara duke përfshirë personat e riatdhesuar. Në muajin Janar ka përfunduar trajnimi i 20 të rinjve , 15 të reja dhe 5 të rinj. Nga grupi prej 20 të rinjve, 5 prej tyre kanë qenë me nevoja të veçanta fizike, 5 të rinj nga ndihma sociale dhe kushte të vështira ekonomike, një nënë e vetme, një grua e re që ka lënë kujdesin alternativ, një e re e divorcuar (abuzuar nga ish i saj -burri), një grua e re me një problem shëndetësor dhe 6 të rinj të papunë. Janë zhvilluar disa takime me sektorin privat, me të cilin kemi arritur një marrëveshje për të angazhuar të rinjtë që kanë qenë pjesë e projektit. Si rezultat, 3 të rinj janë të angazhuar në punë të rregullt (dy vajza dhe një djalë), një vajzë ka filluar praktikën me mundësi punësimi dhe një djalë pritet të fillojë praktikën me mundësi punësimi në një ndërmarrje të ngrohjes qendrore gjatë muajit shkurt. Dy vajza të reja janë angazhuar në hijen e punës në punën administrative në organizatën Akti-Fushë Kosovë. Certifikimi i të rinjve që morën pjesë në trajnim u bë në sallën e Kuvendit Komunal të

Komunës së Drenasit, me ç ‘rast u bë një postim i veçantë në faqen e internetit të Komunës së Drenasit, ku përveç rezultateve të arritura gjatë kësaj kohe të implementimit të projektit, falënderime të veçanta iu drejtuan edhe organizatës e cila u dha këtë mundësi të rinjve të Komunës së Drenasit. Bazuar në nevojat e të rinjve të paraqitur në planet e tyre individuale, u mbajtën 11 seanca të kurrikulës "Aftësitë Themelore të Jetës" dhe 9 seanca të kurrikulës "Punësueshmëria". Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, trajnimet u mbajtën fizikisht dhe në internet. Një vështirësi ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike për disa të rinj që janë zëvendësuar në takimet individuale ato seanca të cilat ata nuk kanë qenë në gjendje të marrin pjesë. Në fillim të muajit Mars është formuar Grupi i dytë për fillimin e trajnimit ku janë përfshirë 20 të rinjë. Gjatë muajve në vazhdim pastaj ka filluar trajnimi dhe janë zhvilluar procedura të njëjta si për grupin e parë. Me datë 08.06.2021 kemi mbajtur takim me tre biznese në Parkun e Biznesit, “Medruplast”, “Euromodel” dhe “Shehu”, mbi kyqjen e të rinjve në tregun e punës. Me datë 24.06.2021 ka përfunduar trajnimi i 20 të rinjve mbi “Shkathtësitë Bazë Jetësore”. Certifikimi i të rinjve u bë në të njëjtën ditë me një rezultat mjaft të suksesshëm si rezultat i përgatitjeve në aspektin e punsushmerisë janë angazhuar: tetë(8) të rinjë në punë direkte, intership (praktikë me pagesë) si dhe praktikë varësisht prej qëllimeve në aspektin e punsushmerisë të së cilit, kurse të tjerë pritet që të angazhon në ditët në vazhdim. Nga gjithë kjo punë kemi gjithsej 40 të rinjë të certifikuar , ku nga ta kemi gjithsej 24 persona të përfshirë në punë direkte, praktikë me pagesë dhe praktikë. I gjithë ky rezultat është arrit falë bashkëpunimit me institucionet dhe bizneset komunale.

1.6. ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Zyra për Barazi Gjinore në Drenas Siguron rekomandime dhe këshilla profesionale Kryetarit të Komunës në formulimin e politikave gjinore dhe integrimin e komponentit gjinor në dokumente strategjike dhe plan programeve lokale ,merr pjesë dhe kontribuon në hartimin e politikave publike në të gjitha nivelet, në kuadrin e grupeve punuese koordinon, zbaton monitoron dhe raporton në institucionin ku bën pjesë, mbi aktivitetet që burojnë nga Programi për Barazi Gjinore për Kosovën në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara në program, mbledhë dhe përpunon të dhëna me bazë gjinore, të natyrës cilësore dhe sasiore, mbi zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Programin për Barazi Gjinore të Kosovës dhe të gjitha strategjitë dhe plan programet në zbatim të hartuara nga komuna ose nga niveli qendror ofron raportime cilësore për Agjencinë për Barazi Gjinore për aspekte barazisë gjinore, në pajtim me kriteret dhe standardet e vendosura për raportim, për të gjitha politikat publike të aprovuara nga Qeveria e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare këshillon Njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, mbi kriteret gjinore në procesin e punësimit me qasje të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas legjislacionit në fuqi bashkëpunon me komunitetin e OJQ-ve dhe partnerë të tjerë potencialë vendor dhe ndërkombëtarë, për koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve, sigurimin e burimeve financiare për zbatimin e politikave publike dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale. Zyra për barazi gjinore gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2021 duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore, planin e punës dhe përshkrimin e detyrave të punës ka realizuar aktivitete të cilat dalin nga fushë veprimtaria e saj si tryeza, takime , trajnime, sesione informuese etj të organizuara në bashkëpunim me ekzekutivin e Komunës të cilat kanë për qëllim promovimin dhe respektimin e barazisë gjinore.

2. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

2.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Periodha raportuese gjashtë mujore e punës në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme përfshinë fushat nga Sektori i Gjendjes Civile, Zyra e Prokurimit, Qendra për Shërbime të Qytetarëve, Shërbimit të Kuvendit të Komunës, Sektori për Teknologji Informative dhe Logjistikë si dhe Sektorit të Arkivit Komunal.

I. Sektori i Gjendjes Civile:

Në sektorin e gjendjes Civile prej datës 01.01.2021 deri me 30.06.2021 janë lëshuar këto dokumente:

1. Ekstrakte të Lindjes- 11519 copë
2. Certifikata të lindjes – 4391 copë
3. Certifikata të martesës – 2715 copë
4. Certifikata të vdekjes -709 copë
5. Certifikata të vendbanimit – 401 copë
6. Certifikata të bashkësisë familjare -1482 copë
7. Certifikata të gjendjes martesore - 823
8. Certifikata të shtetësisë – 115 copë
9. Vërtetime nga Arkiva - 240 copë

Gjithsej certifikata të lëshuara -22 395 copë

Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror - 507

Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm lindjes, vdekje, ndërrim, korrigjim i emrit personal për gjashtëmujorin 2021 janë: **122 Aktvendime.**

Lëndë për humbjen e shtetësisë së Kosovës me lirim janë: 23 lëndë.

Lëndë për fitimin e shtetësisë së Kosovës janë: 4 lëndë.

II. Zyra e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 30.06.2021 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa nga të cilat:

1. Administrata komunale
 2. Institucionet arsimore dhe
 3. Institucionet shëndetësore
- a. Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar **79 procedura**, prej tyre për:
1. Vlera minimale 14
 2. Kuotime të çmimeve 15
 3. Punë shtesë 0 dhe
 4. Procedura të hapura 49
 5. Procedure me Negociata 1
- b. Janë nënshkruar **56 kontrata**, prej tyre për:
1. Vlera minimale 14
 2. Vlera të vogla 17 (ka edhe procedura me loto) dhe
 3. Vlera të mesme ose të mëdha 25 (Furnizime , shërbime dhe punë)
- d) Anulime (8) dhe Ri-tenderime (7) të njoftimeve për kontratë

III. Qendra për Shërbime të Qytetarëve (QSHQ):

Qendra për Shërbim të Qytetarëve gjatë periudhës 01/01/2021-30/06/2021 ka regjistruar gjithsej 13 692 lëndë të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese, siç janë:

- Janar: janë regjistruar 2 263 lëndë të ndryshme;
- Shkurt: 2.512 lëndë;
- Mars: 2. 275 lëndë;
- Prill: 1. 820 lëndë;
- Maj: 1. 944 lëndë;
- Qershor: 2.878 lëndë;

Qendra për Shërbim të Qytetarëve përmes sistemit elektronik ka ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Në këtë sektor është dhënë prioritet në ofrimin e sa më shumë shërbimeve, duke krijuar mundësinë që qytetarët fare të mos frekuentojnë fizikisht në zyrat e komunës. Bazuar në anën ligjore, Qendra për Shërbim të Qytetarëve ka përmbushur të gjitha objektivat e parapara me planin e punës, për organizimin dhe funksionalizimin e QSHQ-së.

Kemi punuar në kërkesa fillestare (në formë tabelare) për pagesa të shërbimeve dhe pagave të cilave ua kemi bashkangjitur edhe raportet për pranim të shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe kemi punuar në sistemin e brendshëm (intranet) ku i kemi bashkangjitur lëndët dhe kemi aprovuar/refuzuar lëndët e DAP dhe Zyrës së Prokurimit.

IV. Shërbimet e Kuvendit të Komunës

Në periudhën raportuese janar-qershor 2021 të Kuvendit Komunal Drenas, janë mbajtur gjithsej:

- Mbledhje të rregullta 6 (gjashtë),
- Mbledhje të Komitetit për Politike dhe Financa 6 (gjashtë) mbledhje.
- Mbledhje të jashtëzakonshme gjatë periudhës janar-qershor 0.
- Mbledhje Solemne 3 (tre)

Gjithsej Kuvendi i Komunës ka mbajtur 9 mbledhje.

Gjatë periudhës janar-qershor Kuvendi i Komunës ka aprovuar gjithsej 23 Vendime

Rregullore 00.

Gjithsej akte të aprovuara: 23.

Të gjitha vendimet janë të publikuara në ueb faqen e Komunës së Drenasit.

V. Sektori për Teknologji Informative dhe Logjistikë

Raporti i punës bazohet mbi punët e kryera në baza ditore të domosdoshme dhe varësisht nga kërkesat e zyrtarëve komunal. Në raportet ditore që mban zyra për teknologji informative janë të specifikuara se tek cili zyrtarë është bërë intervenimi dhe çfarë problemi ka pasur .

Punët bazike të Zyrës së IT-së (çdo ditë) :

- Kontrolli ne dhomën e SERVER-ave dhe mirëmbajtja e SERVERA-ve (çdo ditë në fillim të orarit të punës).
- Kontrollimi i rrjetit në Komunë dhe në Zyrat Lokale të Gjendjes Civile, QKMF, QPS, ZP, QRA dhe QKRC (çdo ditë në fillim të orarit të punës)
- Aplikimi për kërkesat e zyrtarëve ne SMAED, SIMBNJ dhe kërkesa tjera.
- Dhënia e qasjes, trajnimi ne përdorim ne te gjitha E- shërbimet tek te gjithë zyrtaret

- Komunikimi me ministritë varëse rreth problemeve me rrjet dhe qasjeve te cilat kërkohen nga zyrtaret.
- Instalimet, Konfigurimet me asetet e komunës (pajisjet e teknologjisë, kompjuter, server, printer, telefona etj).
- Ruajta e shënimeve të Zyrtareve nga MAP Draiveri ne DATA CENTER
- Ndryshimet ne privilegjet e zyrtareve sipas kërkesave ne Aplikacione
- Mirëmbajtja e llogarive zyrtare, aktivizimi i llogarive te reja.
- Menaxhimi i Activ Direcory
- Mbledhja e Kuvendit –Transmetim, incizim, votimi elektronik, postim ne ueb faqe

Raporti i punës në zyrën e Teknologjisë Informative : Nga Data - 03/01/2021 deri me 30/06/2021		
Zyrtari :Ukë Krasniqi		
Drejtoria	Kërkesa nga Zyrtari	Lloji i intervenimit - Problemit
DAP	GJC	93 intervenime
DAP	QSHQ	113 intervenime
ZK		65 intervenime
DF		130 intervenime
DI		84 Intervenime
DKRS		75 intervenime
DSHMS		143 intervenime
DGJKP		77 intervenime
DUMM		118 intervenime
DIL		87 intervenime
DBZHR		118 intervenime
DZHE		102 intervenime
DA		122 intervenime
DSHPS		94 intervenime

• **Zyrtari për Pranim të Mallit-Depoist dhe Logjistikë**

Gjatë kësaj periudhe 01.01.2021-30.06.2021 janë kryer këto punë dhe detyra:

1. Regjistrimi i inventarit të Komunës së Drenasit në regjistrin e excelit në bazë të ditarëve të punuar nga komisioni për regjistrimin dhe vlerësimin e inventarit të komunës,

2. Azhurimi i raportit për regjistrimin e Inventarit të Komunës, nga komisioni i caktuar për verifikimin e zyrtarëve të cilët nuk janë më pjesë e stafit të komunës.

3. Shkarkimi dhe ngarkimi i inventarit nga të gjithë zyrtarët e Komunës,

4. Pranimi, evidentimi i të gjitha kërkesave nga drejtoritë komunale, për pagesën e faturave sipas Kontratave të lidhura nga zyra e Prokurimit për punë, furnizimet dhe shërbimet e kryera dhe të pranuar nga Njësitë kërkuese.

5. Në FREEBALANCE sipas GRNS - Raporte të Pranimi për të gjitha Njësitë Kërkuese janë nxjerrë gjithsej 231 raporte për pagesa të ndryshme në bazë të faturave të pranuar nga të gjitha drejtoritë.

6. Raporti i pranimi të mallrave arrin vlerën 26013.09 €.

Në sistemin e E-pasurisë janë regjistruar të gjithë artikujt sipas faturave nga Njësitë Kërkuese për mallin e pranuar në E-Depo me vlerën nën 1000 euro.

Të gjithë Zyrtarët janë ngarkuar me mallin e porositur nga Njësitë Kërkuese dhe janë nënshkruar në fletë ngarkimin e mallit si dhe të gjitha pagesat të cilat kanë shkruar për certifikim janë skanuar dhe regjistruar për ç'do secilën pagesë veç e veç sipas drejtorive.

Është mbajtur evidenca e regjistrimit të faturave të rexhistruara në E-pasuri në formë elektronike si dhe në fletore të punës regjistruar në menyrë fizike (bashkangjitur gjeni regjistrin e faturave të regjistruara në exel.

Logjistikë (Zyrtari për mirëmbajtjen e veturave, shpërndarësi i postes, shtëpiaku/fokisti, recepcionisti):

Zyrtari përgjegjës është përkujdesur për mirëmbajtjen e veturave të Komunës që të jenë të pastërta brenda dhe jashtë, ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të sigurisë, servisimit rutinor dhe regjistrimit të veturave zyrtare. Përdorimi i veturave për punë zyrtare është respektuar sipas rekomandimeve, për përdorim zyrtar të veturave sipas kërkesave të pranuar me postë elektronike.

Shpërndarësi i postes ka kryer sipas nevojës dhe kërkesave të shërbimeve, çdo herë shkresat janë përcjell me kohë dhe saktësi, ku gjatë kësaj periudhe ka shpërndarë 1857 shkresa të ndryshme (vendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe jashtë saj.

Shërbimet në mirëmbajtjen e objektit dhe inventarit nga ana e zyrtarit përgjegjës janë kryer sipas kërkesave për intervenim. Përkujdesa për mirëmbajtjen e sistemit energjetik në objektin komunale ka qenë në nivel, problemet të cilat janë paraqitur në kohë janë eliminuar nga punëtori i autorizuar. Punëtoret e shërbimeve kanë kryer punë dhe detyrat tjera sipas kërkesave nga ana e zyrtarëve.

Recepcionisti, ka vazhduar me udhëzimin e palëve në të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale ku janë pajisur me kartela të vizitorëve. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë rreth 2220 qytetarë që kanë kërkuar shërbime në drejtoritë komunale vetëm në katin II, të cilët janë pajisur me kartela të vizitorëve dhe janë regjistruar në evidencë. Zyrtari përgjegjës ka udhëzuar palët sipas nevojës gjatë orarit zyrtar, ka dhënë informacione palëve lidhur me kontaktet me zyrtarët, ka evidentuar parregullsitë që vërehen në hyrje-dalje të portës.

VI. Sektori i Arkivit Komunal

Ne si Drejtori e Administratës, përmes Sektorit të Arkivit, ju kemi njoftuar me tre shkresa, radhazi, që në vitin 2018 kemi filluar Arkivimin e Lëndëve sipas ligjit dhe UA-ve në fuqi lëndët duhet të arkivohen në mënyrë Fizike dhe Elektronike. Secila Drejtori ka obligim ligjor që lëndët e përfunduara të kthehen në arkivin komunal për ruajtjen e mëtutjeshme. Mirëpo edhe për kundër faktit që kemi dhënë sqarime të nevojshme ligjore dhe teknike edhe në vitin 2021 kthimi i Lëndëve për arkivim Fizik, nuk është i mjaftueshëm nga ana e Drejtorive, [shiko tabelën në vijim;

Baza Ligjore;

- Ligji nr. 2003/7, për Lëndët Arkivore dhe Arkivat,
- Ligji nr. 04 / L-184 për Administrimin e Punëve në Zyrë.
- Udhëzimi administrativ [MAP] nr-01/2017 për administrimin e punëve në Zyrë, evidencat themelore dhe detyrat e punës së Arkivistit,
- Rregullore [MAP] nr. 01/2015 për shenjat e klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre.

Ne vazhdim po e paraqesim në mënyrë tabelare numrin e lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike sipas Programeve dhe Drejtorive.

1.	Zyra e Kryetarit të Komunës	245	Lëndë
2.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	558	Lëndë
3.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	00	Lëndë
4.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	289	Lëndë
5.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	11	Lëndë
6.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	00	Lëndë
7.	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	00	Lëndë
8.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	23	Lëndë
9.	Drejtoria për Arsim	00	Lëndë
10.	Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport	00	Lëndë
11.	Drejtoria e Inspektimit Komunal	736	Lëndë
12.	Zyra e Kuvendit	71	Lëndë
13.	Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë	00	Lëndë
14.	Zyra për Komunitete dhe kthim	00	Lëndë
15.	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	00	Lëndë

Numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë fizike për të gjitha programet për gjashtëmuorin e vitit 2021 është 1933.

Ndërsa numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet për gjashtëmuorin 2021 është 12.580.

Sektori i arkivit kryen edhe punë tjera në shërbim të qytetarëve si vijon;

- Deklaratë për ushqim për vitin kalendarik, mbajtës i familjes, për bashkatdhetarë për të gjitha shtetet 358 lëndë.
- Certifikatë për shtesa të fëmijëve, për punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja 10.

- Vërtetim mbi jetën për të gjithë bashkatdhetarët 70.
- Deklaratë e udhëtimit, për shtetas të huaj.
- Legalizimin e të gjitha dokumenteve nga original 35.
- Për këto shërbime në vitin 2021 kemi proceduar 473 lëndë.

Punë tjera;

Raporti mujor për ndryshimet në listën e zyrtarëve të lartë publik që janë të obliguar për Deklarimin e pasurisë nga Komuna e Drenasit në Agjencinë Kundër korrupsionit, në cilësinë e Zyrtarit Kontaktues nga Komuna e Drenasit. Dërgimi i listës së zyrtarëve të lartë publik për deklarim të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, për Komunën e Drenasit, deklarimi i rregullt vjetor, ku në vitin 2021 në baze të ligjeve në fuqi për Komunën tonë kanë qenë të obliguar 48 zyrtarë të lartë publik të deklarojnë pasurinë.

2.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Raporti i punës së Drejtoratit për Arsim (DKA) paraqitur kryetarit të komunës përfshinë periudhën prej muajit Janar-Qershor - 2021. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati janë realizuar gjatë kësaj periudhe me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë. Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellë me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë. Përkundër pandemisë shumica e shkollave në komunën e Drenasit kanë punuar sipas skenarit A (me prezencë fizike në shkollë) —Në bazë të numrit të rasteve me covid nga ana e mësimdhënësve shkollat kanë kalura në mësim online sipas planit B për perjudhë dy javore (MASHTI)

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 11 punëtor: Drejtori, një zyrtar për personel, dy zyrtar për arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një punëtor për lista të pagave dhe arkivim, një zotues, një depoist. Drenasi ka një Institucion parashkollor publik me një paralele të ndarë fizike, 30 shkolla fillore dhe të mesme të ultë me 2 paralele të ndara fizike, dy shkolla të mesme, gjithsejtë 36 institucione arsimore publike. Ku punojnë gjithsejtë 957 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 11690 nxënës. 54 punëtor administrativ, 766 mësimdhënës, 131 punëtor teknik. Institucioni Parashkollor Publik “Ardhmëria” ka gjithsejtë 141 fëmijë, klasa përgatitore 830 fëmijë, shkollat fillore dhe të mesme e ulët prej (I - IX) ka gjithsejtë 7338 nxënës, SHML Gjymnazi “Gj.K.Skënderbeu” ka gjithsejtë 1004 nxënës dhe ShMP “Fehmi Lladrovci” ka gjithsejtë 1483 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS - Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të Institucioneve Arsimore në Drenas, i është dhënë përkrahje e vazhdueshme e shkollave për përmirësimin e performancës dhe ngritjen e cilësisë me bazë në shkollë. DKA -Drenas në Qershor 2021 ka shtrirë projektin për Vlerësimin e brendshëm të shkollave, duke i përfshirë të gjitha shkollat në vlerësimin e brendshëm të shkollës duke i mbështet dhe financuar trajnerët si ekip profesional në ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Komuna Drenasit tanimë e kanë të përfunduar vlerësimin e brendshëm të shkollave me vlerësimin e 5 (pesë) fushave të cilësisë. Ekipi profesional për implementimin e KKK-së, për hartimin planifikimeve vjetore komunale për nivelin arsimorë 0-1. Me vendim të DKA-së janë organizuar takime informues trajnerët dhe mësimdhënësit lidhur me hartimin e plan-programeve mësimore për nivelin komunal. Diskutim lidhur me identifikimin, ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira për zbatimin dhe realizimin e

plan-programeve si dhe realizimin e tyre. Çertifikimi i mësimdhënësve (sipas kritereve) që kanë zbatuar për herë të parë kurrikulën për vitin shkollor 2019/2020. Hartimi i Planit Operacional për trajnimin për mësimdhënësit e klasës përgaditore dhe nivelin arsimor fillor për 5 modulet e trajnimit sipas projektit “Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve në arsimin fillor “. Duke e parë rendësin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në ngritjen e cilësisë në arsim, DKA-ja ka shtrirë projektin “Qasja praktike për zbatim të kurrikulës 0-5 dhe mentorimi me bazë në shkollë duke përfshirë në këtë fazë 8 shkolla me gjithsej 74 mësimdhënës si dhe çertifikimin e tyre. Materialet dhe udhëzuesit e përgatitur nga “Projekti zhvillimi profesional i mësimdhënësve”. Shtrirja e projektit për trajnimin e mësimdhënësve për ngritjen e vazhdueshme profesionale , është mbështetur ,koordinuar nga DKA-ja , dhe ekipi i trajnerëve për ngritje profesionale me vendim të DKA-së. Është planifikuar dhe realizuar mbajtja e testit të arritëshmërisë dhe të maturës, ku organizimi është vlerësuar jashtëzakonisht mirë nga administruesit e testit në nivel MASHTI. Paraqitja e pandemisë COVID- 19, ka paraqitur vështirësi dhe sfida të mëdha duke rezultuar në humbjen e orëve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.Andaj , nga 07.05.2021 është konstatuar se organizimi i mësimi plotësues është parë një prej mundësive që do të lehtësonte humbjen e mësimi ,përsheptimin e të nxënësve, dhe përmirësimin e rezultateve në të nxënësve . Në vijim paraqesim të dhënat për nxënësit nga Komuna Drenasit që kanë mbajtur mësimin plotësues në këto fusha kurrikulare .

Fushat Kurrikulare	Nr i nxënësve	Numri i orëve të realizuara	Përqindja
Gjuhë dhe Komunikim	4146	1347	38.68%
Matematikë	4403	1335	41.08%
Biologji	1920	949	17.93
Fizikë	2062	493	19.24
Kimi	2240	459	20.90%

Është kërkuar respektimi në përpikëri i ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerra nga MASHTI-i. Janë realizuar takime me prindër, është zgjedhe keshilli I prindërve në nivelin komunal. Gjatë kësaj periudhe është monitoruar mbarëvajtja e procesit edukativ arsimor. DKA-ja edhe gjatë pandemisë ka realizuar takime të rregullta dhe virtuale te vazhdueshme me nivelin qendrorë dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e procesit mësimor. Kemi pranuar raporte të rregullta në baza ditore nga të gjithë drejtoret e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ka qene ne nivel ashtu siç është kërkuar në këto rrethana. Si DKA ju kemi bërë të qarte të gjithëve detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimi me prezenc fizike dhe në distance konformë udhëzimeve te pranuar nga MASHTI. Të gjithë mësimdhënësit i kane formuar grupet e komunikimit dhe kanë qene ne kontakt te vazhdueshëm me prindërit dhe nxënësit duke e përcjellë angazhimin e nxënësve dhe kryerjen e detyrave.

DKA ka përfshirë 65 FAMNV në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha institucionet arsimore në nivelet 0,1,2 dhe 3, duke ju ofruar mbështetjen profesionale në edukim, arsimim. Janë zbatuar politikat arsimore në bazë të kapaciteteve të lejuara administrative me sistemin e pesë (5) mësimdhënësve mbështetës dhe katër (4) asistentëve mbështetës, me qëllim të ngritjes së arritjeve të tyre në procesin edukativ arsimor. Integrimi dhe mbështetja e FAMNV bazohet në U.A. Nr. 16/2017, rregulloren e punës dhe planit zhvillimor të koordinatorit për arsim gjithëpërfshirës, ndërsa shkalla e vlerësimit të FAMNV bëhet nga ekipi komunal për vlerësim. Hartimi i planit PIA bëhet me akteret : edukator/e, mësimdhënës, asistent, prind për secilin fëmijë/ nxënës për fushën që e ka pengesën në zhvillimin e tyre, i cili plan ndihmon në produktivitetin e tij/saj për arritjet në procesin edukativ mësimor dhe ngritje në përformacën jetësore. Rastet e referuara nga prindërit, edukatorët, mësimdhënësit dhe drejtoret e shkollave për nxënësit me sjellje jo të mira sociale në procesin edukativ arsimor janë trajtuar në mënyrë profesionale duke bashkëpunuar edhe me institucionet e shtetit si: Gjykatën, Policinë, QPS, Sherbimin Sprovues-i cili me vendim të Prokurorit vendos për Masën e Diversitetit si Këshillim Psikologjik profesional, poashtu edhe me referenca të organeve të sigurisë për kujdesin dhe përmirësimin e sjelljeve devijante të miturve në institucione arsimore, në disa raste edhe në përmirësimin e raporteve mësues-nxënës-prind-shkollë dhe anasjelltas.

Sa i përket menaxhimit me personel dhe administratë në 6-të mujorin e parë të këtij viti janë realizuar aktivitetet në vijim:

Konkurse -----	19
Shpallje të rezultateve të konkurseve-----	19
Vendime të komisioneve intervistuese -----	15
Vendime për transfërim -----	2
Vendime të lehonisë -----	19
Aktvendime për pensionim -----	12
Aktvendime për ndërprerje të marrdhënies së punës-----	5
Aktvendime të pushimeve pa pagesë-----	1
Vendim, aktvendime të tjera, të ndryshme -----	81
Aktvendime të refuzuara-----	7
Aktvendime të aprovuara-----	190
Njoftime të ndryshme -----	28
Njoftime për ushqim -----	89
Njoftime për udhëtim-----	73
Njoftime për gradime shtesë -----	478
Hartimin e pëlqimeve të ndryshme -----	21
Hartimin e kërkesave të ndryshme-----	9

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Hartimin e ankesave të ndryshme ----- 3

Vërtetime të ndryshme ----- 13

Autorizime të ndryshme ----- 4

Në kuadër të menaxhimit me personel kemi bashkëpunuar më përfaqësues të Avokaturës Shtetërore, Inspektor të MASHTI-të, Inspektorin e Punës në Drenas, Inspektor në MPMS-Prishtinë. Kemi kalkuluar koston e shpenzimeve që burojnë nga kontrata kolektive dhe të njëjtën e kemi përcjell në Ministrinë e Arsimit dhe të Financave

DONACIONET - Edhe në këtë perjudhë nuk kanë munguar donacionet: Nga MASHT ka vazhduar ndërtimi i palestrës sportive në Poklekë. Nga MZHE është siguruar renovimi i SHFMU “Deshmoret e Drenices” në Verbovc. Janë implementuar granatet nga Banka Botërore në 3 shkolla: SHFMU “Ali Gashi” – Drenas, SHFMU “24 Korriku” në Fushticë, SHFMU “Arif Shala” në Korroticë të Ulet. Nga MAPL janë edhe ndërtimi i dy shkollave: SHMP në Komoran dhe SHFMU në Fushticë të Epërme, ku është duke vazhduar ndërtimi i tyre në fazat e punimeve të vazhda.

INVESTIMET KAPITALE Gjatë këtij viti kalendarik në drejtorin e arsimit kanë qenë të planifikuara 8 projekte kapitale këtu janë përfshirë disa projekte mirpo janë grupuar në mënyrë që të realizojm më pak shpallje, nga këto projekte 6 kane qenë me burimin e fondeve grante qeveritare (10), dhe 2 kane qenë nga të hyrat vetanake si dhe 2 me kombinimin e të dy burimeve të fondeve (10 dhe 21).

RAPORTI GJASHTËMUJOR I I PUNËS ,REALIZIMI I BUXHETIT GJASHTËMUJORI I PARË/2021 BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,Grantet qeveritare fondi burimor 10 Tabela nr.1,Pagat,Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime komunale

N r.	Drejtoratet	Buxh eti i apro vuar 2021, Pagat	Buxh eti i apro vuar 2021, Mallr a dhe Shërb ime	Buxheti i apro vu ar 2021,Sh penzim e komuna le		Buxh eti i apro vuar 2021, Pagat - Aloki met	Buxh eti i apro vuar 2021, Mallr a dhe Shërb ime- Aloki met	Buxheti i apro vuar 2021,Sh penzime komuna le- Alokim et	Buxheti i apro vuar 2021,Sub vencionet - Alokimet	Kapi talet - Alo kim et	Buxh eti i apro vuar 2021, Pagat - Shpe nzime t	Buxh eti i apro vuar 2021, Mallr a dhe Shërb ime- Shpe nzime t	Buxheti i apro vuar 2021,Sh penzime komuna le- Shpenzi met	
1	Administrat a e Arsimit	76,21 2	315,2 66	-		61,54 0	258,7 51	-	-	335, 000	61,54 0	153,2 63	-	
2	Arsimi Parafillorë- QEAP"AR DHMERIA "	118,6 15	46,46 2	6,120	- -	73,40 1	14,84 2	3,570	-		73,40 1	7,185	1,044	
3	ARSIMI FILLOR	4,548 ,372	321,7 89	61,312	- -	2,809 ,782	272,2 90	33,442	-	-	2,808, 251	178,1 44	13,737	

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

4	ARSIMI I MESEM	1,290,482	95,507	21,125	-	-	760,330	71,507	11,520	-	-	760,330	48,425	560
---	----------------	-----------	--------	--------	---	---	---------	--------	--------	---	---	---------	--------	-----

RAPORTI GJASHTËMUJOR I I PUNËS ,REALIZIMI I BUXHETIT GJASHTËMUJORI I PARË/2021

BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,Të hyrat vetanake nga fondi burimor 22 dhe 21,SUBVENCIONET/Bursa për student

Tabela nr.2, dhe Mallra dhe Shërbime

Nr.	Drejtoratet		Buxheti i aprovuar 2022,Mallra dhe Shërbime	Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime	Buxheti i aprovuar 2022,Subvencione t	Buxheti i aprovuar 2021,Subvencionet		Buxheti i aprovuar 2022,Mallra dhe Shërbime-Alokimet	Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime-Alokimet			
1	Administrata e Arsimit	-	-	-	4,350	80,000						
2	Arsimi Parafillorë-QEAP"ARDHMËRIA"	-	24,123	25,000				24,123	16,364			
3	ARSIMI FILLOR	-										
4	ARSIMI I MESEM	-										

RAPORTI GJASHTËMUJOR I I PUNËS ,REALIZIMI I BUXHETIT GJASHTËMUJORI I PARË/2021

BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,KAPITALET Grantet qeveritare fondi burimor 10,21,22

Tabela nr.3

N r.	Administrata e Arsimit			Kapitalet Aproximi Fondi 22,Grantet	Kapitalet Aproximi Fondi 21,Grantet	Kapitalet Aproximi Fondi 10,Grantet					Kapitalet-Alokimet			Kapitalet - Shpenzimet
------	------------------------	--	--	-------------------------------------	-------------------------------------	-------------------------------------	--	--	--	--	--------------------	--	--	------------------------

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

1	Renovimi i objekteve shkollore(Kulm,d ysheme dhe ndërrimi I dyerve dhe dritareve				5,340					5,340				5,340
2	Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore				50,000					50,000				18,666
3	Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve dhe trotoreve me kubëza				45,000					45,000				10,033
4	Inventarizimi i shkollave në Drenas				40,000					40,000				27,749
5	Furnizimi i shkollave me pajisje të TI				50,000					50,000				në proces
6	Furnizimi i shkollave me kabinete:kimi,fizi kë dhe biologji				60,000					60,000				në proces
7	Rrethojat e oborreve shkollore			5,215						5,215				në proces
8	Renovimi i objekteve shkollore(Kulm,d ysheme dhe ndërrimi I dyerve dhe dritareve				64,660					31,225				në proces

RAPORTI GJASHTËMUJOR I I PUNËS ,REALIZIMI I BUXHETIT

GJASHTËMUJORI I PARË/2021

BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,PROJEKTET E Bankës Botërore,Financim nga Huamarrja,Fondi burimor 04,

Tabela nr.4, Bartje e mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021

N r.	Drejtoratet	Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime,TR AJNIME	Kapitalet;FU RNIZIM ME TI DHE PAJISJE TJERA;KABINETE ETJ.	Buxheti i alokuar 2021,Mallra dhe Shërbime,TR AJNIME	Mallr a dhe Shërbi me ,Aloki met	Kapit alet- Aloki met	Kapital et- Shpenz imet
1	1.SHFMU"ALI GASHI",2.SHFMU"ARIF SHALA"DHE 3.SHFMU "24 KORRIKU"	9,460	6,586	9,460	9,460	6,586	6,375

KOMUNIKIMI ME MASHT-in - Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in, ku kemi dhënë kontributin tonë me nevojat dhe prioritet tona si DKA në sferën e arsimit. Në çdo mbledhje me drejtore të drejtorive Komonale për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i. Kemi dërguar disa kërkesa për përkrahje të cilat janë në proces: Kërkesë për përkrahje në pako për laboratorë (fizike, kimi, biologji), kërkesa për renovime të tualeteve të shkollave, kërkesa për themelime

të institucioneve parashkollore publike me qëndrim tërëditor, kërkesa për furnizim me inventarë për klasat përgatitore etj.

BASHKËPUNIMI ME BE-në - Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar takime me përfaqësuesit e BE-së lidhur me donacionin “Ndërtimi e institucionit parashkollor publik për fëmijë me qëndrim tërëditor”. Punimet kane filluar dhe janë duke u zhvilluar në ndërtimin e objektit. Janë certifikuar shumica e mësimeve nga projekti i BE-së implementuar nga GIZ-i në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimeve kanë vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Kemi realizuar 3 konferenca nderkombetare krahas shkollave të Bashkimit Evropian me ekspert të ndryshëm të kurrikulave duke trajtuar tema që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë në mësime dhe mësuesi.

VËSHTIRËSITË – Pandemia ka shkaktuar vështirësi të shumta në të gjitha dimensionet, obligimet financiare që dalin nga implementimi i kontratës kolektive (kërkesa të medha për shujta, gradim dhe transport). Gjithashtu kemi kërkuar edhe trajnimin e zyrtarëve të administratës me qëllim të ngritjes profesionale në sektorin përkatës. Stafi profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

PËRFUNDIM- Jemi të vetëdijshëm për sfidat që kemi përpara vetës edhe në këtë vit. Mbesim të perkushtuar me angazhim maksimal që në Drenas të ngritet cilësia në arsim, të shtohet disiplina në punë dhe të këtë llogaridhënie në këtë drejtim. Për të krijuar kushte dhe mundësi të reja në rrethanat e reja shtetërore që sot e nesër të kemi shkolla efektive dhe funksionale në kuptimin e plotë të fjalës, vlen që të gjithë të angazhohemi për ta ngritur sa më lartë cilësinë në arsim. Për këtë kemi krijuar një komision i cili ka për detyrë të skanojë gjendjen në teren dhe të nxjerr rekomandime në funksion të përmirësimit të cilësisë.

2.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Aktivitetet kryesore në gjashtë-mujorin e parë Janar-Qershor 2021	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë 6 muajve (janar-qershor/2021)
--	---

Aktivitetet kulturore	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës dhe për periudhën janar-qershor i ka kryer këto aktivitete: - Raporti vjetor i DKRS-së për vitin 2020 - Plani dhe programi i punës për vitin 2021 Aktivitete në Sektorin e Kulturës: - Si DKRS në respektim të vendimeve të qeverisë dhe masave tjera mbrojtëse të rekomanduara nga OBSH dhe IKSHPK, për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID-19, jemi obliguar të reduktojmë dhe mbajmë me masa kufizuese aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore; - Takim me Presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Koordinimi për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në realizim të aktiviteteve të përbashkëta sportive; - Pjesëmarrje në ekspozitën “Edhe unë mundem, më përkrahni” organizuar nga Handikos Drenas; - Mbajtja e Festivalit të Tunxhit “Kosova Brass Fest” në Sallën e Kulturës më 04.02.2021. - Manifestimin për 17 shkurtin-Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, filloi duke bërë homazhe tek shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, në kompleksi memorial në Marinë dhe tek të gjitha vend varrezat e dëshmorëve në komunën e Drenasit, - Janë bërë homazhe për dëshmorët dhe heronjtë tanë duke vendosur kurora lule pranë vendvarrezave në përvjetorët e tyre; - Është shënuar 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas; - Është shënuar me akademi 40 Vjetori i demonstratave të 2 prillit të vitit 1981; - Është shënuar aktiviteti kulturor i Sofrës Poetike “Ymer Elshani” 2021 në formatin virtual për shkak të masave mbrojtëse ndaj pandemisë Covid-19; - Në bashkëpunim me DKA-në kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve-1 Qershorin, ku si DKRS kemi realizuar aktivitetin e ngjyrosjes me të gjithë fëmijët e Çerdhes “Ardhmëria”; - Me rastin e shënimit të 21 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe bilborda me mbishkrim me 11.06.2020 ndërsa me 14.06.2020 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe te shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë (për shkak të situatës pandemike nuk është mbajtur ndonjë aktivitet tjetër festiv); - Është përvjetorja e Heroit Dr. Hafir Shala në oborrin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas; - Është shënuar 22 vjetori i Ditës së Çlirimit të komunës së Drenasit, me ç’ rast janë bërë homazhe tek shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, në Kompleksin Memorial në Marinë dhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë; Me kërkesa të DKRS-ës dhe bashkëpunim me autor librash kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona libra të rinj të cilat i dhuruan:
-------------------------------------	---

Autorja Xhevahire Morina	5	2021
Autori Riza Greiçevci	200	2021
Autori Hisni Gashi	50	2021
Biblioteka Kombëtare “Pjetër Bogdani”	237	2021
Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit	202	2021

Arkivi komunal:

- Pranimin e 2 kërkesave nga hulumtues për punim shkencor për të dhënat e Arkivit Historikun e fondeve arkivore ofrimin e të dhënave për përgatitjen e punimeve etj. 4 palë kanë marrë certifikata shkollore në fondet e shkollave nga arkivi. 10 palë janë shërbyer nga arkivi me dokumente të kopjuara, nga arkivi për lokale shtëpi dhe njoftime të ndryshme. Gjithsejtë 16 dokumente dhe njoftime të lëshuara nga Arkivi të evidentuara në Protokollin e Arkivit.
- Skanimin e lëndëve të fondit nr. 5 revista të vitit 2010 të RFBSH-së;
- Verifikimin e raporteve Narrative dhe financiare të pranuar nga OJQ-të Kulturore,
- Pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të Inventarit në organet e Administratës së Përgjithshme për vitin 2020 përgatitjen e Raportit përfundimtar dhe dërgimin Zyrës së Kryetarit.
- **Punë të tjera të kryera nga zyrtari për arkiv dhe kulturë**
- Përpunimin e lëndëve në zyrën e DKRS-së në komunë të vjetër, klasifikimin, regjistrimin renditjen dhe përgatitjen e procesverbalit për dorëzim shefit të DKRS-së në zyrën e komunës së re, shpërndarjen e librave të autorit Bardhyl Mahmuti “**Mashtrimi i Madh**” që i kemi marr në zyrën e DKRS-së në objektin e komunës së vjetër, nëpër Bibliotekat e Komoranit, Tërstenikut, Drenasit dhe të Arllatit nga 20 ekzemplarë;
- Përpunimin e lëndëve të Intranetit për DKRS dhënien e statusit të tyre, bashkëngjitjen e lëndëve shitesë etj.
- Pranimin e Raporteve Narrative dhe Financiare të OJQ-ve Kulturore dhe Individëve, kontrollimin e dosjeve dhe përgatitjen e raportit përfundimtar dhe dërgimin zyrës së Kryetarit të komunës dhe DKRS-së.
- Plotësimin e Tabelave në Excel me të dhënave të gjitha OJQ-ve Kulturore, Sportive, Rinore së bashku me zyrtarin e Sportit, të pranuar nga Drejtorati për Buxhet financave;
- Përgatitjen e raporteve të komisionit për pranim të mallrave për DKRS,
- Përgatitjen e kërkesave, kontratave për punëtoret e Palestrës dhe Stadiumi Sintetik që janë me kontrata të MSHV.
- Përgatitjen e deklaratës së nevojave për kontratë kornizë tri vjeçare, dërgimin e lëndës ZP përmes Protokollit,

- Pranimin e vendimit për emërim të menaxherit të kontratës “Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”, plotësimin e procedurave në E- prokurim, nënshkrimin e planit të menaxherit, përgatitjen e lëndëve dhe procedimin për pagesë në Drejtoratin e Financave etj.
- Takime pune me grupin lokal të veprimit i caktuar me vendim të Kryetarit të komunës me OJQ Akti dhe me përfaqësuesit e bizneseve, me të rinjtë e trajnuar për punësim diskutim për rekrutimin dhe fillimin e trajnimit me të rinjtë, hartimin e një raporti mbi bazën e nevojave dhe rekomandimeve për të rinjtë në tregun e punës.
- Evidentimin e lëndëve arkivore të fondit nr. 30 të Drejtoratit për Administratë të Përgjithshme;
- Pranimin e një kërkesë nga Drejtoresha e Drejtoratit për Urbanizëm për lejimin e kontrollimit të lëndëve në Arkiv nga zyrtarja Flora Thaçi për të gjetur vendimin të cilin na është dërguar në emalin zyrtar,
- Skanimin e librit të Amzës nr. 4 me të dhënat e nxënësve të fondit nr. 1 të fondit të shkollës fillore “Bashkimi” me emra të nxënësve dhe suksesin e tyre,
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga IKAP për dy ditë radhazi për menaxhimin e kontratave, shkëmbim bisedash për menaxhimin e kontratave dhe eliminimi i defekteve në procesin e realizimit të tyre,
- Takim me komisionin për vlerësimin dhe shqyrtimin e ofertave në projektin: Furnizim me topa dhe rekuizita sportive-kontratë Kornizë për tri vite, llogaritjen e paramasave dhe parallogarive, përgatitjen e raportit përfundimtar dhe dërgimin Zyrën e Prokurimit.
- Vizitë të burimi i ujit të Kroit të Mbretit së bashku me komisionin e caktuar nga zyra e kryetarit për të vlerësuar gjendjen hapësirës së dëmtuar, përgatitjen e raportit përfundimtar dhe dërgimin zyrës së kryetarit dhe DKRS-së
- Përgatitja e materialit të kërkuar nga Zyra e Informimit me të dhënat për promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.
- Pjesëmarrje në trajnim një ditë së bashku me zyrtaren e Drejtoratit të Zhvillimit Ekonomik për Trashëgiminë Kulturore dhe Turizmin,
- Pranimin e dy shkresave nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit të Turizmit dhe Zyrtari i Lartë për Standarde dhe Cilësi të Turizmit me tabela për plotësimin e atraksioneve turistike, përgatitjen e materialeve plotësimin e fushave sipas kategorive dhe llojit të monumenteve kontrollimin e materialit së bashku me zyrtaren e DZHE.
- Përgatitjen e listës së kërkuar nga zyra e Informimit me të dhëna ne promovimin e Kulturës dhe trashëgimisë kulturore klasifikimin e monumenteve Natyrore dhe Kulturore plotësimin me të dhëna dhe dërgimin zyrës së informimit.

Bibliotekat në Komunën e Drenasit gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021 kanë këtë pasqyrë:

	Muaji- Janar-Qershor 2020	Nr. i ekzemp.	Nr i titujve	Ekzemplar të ri	Libra të lexuara	Nr. i lexuesve	Lexues të ri	Gjithsejt ë lexues
	Drenas	9457	3756	527	1245	605	152	757
	Terstenik	4294	1419	65	65	115	14	118
	Arllat	5154	954	0	329	292	5	297
	Komaran	3549	2060	340	216	233	18	233
	TOTALI	22454	8189	932	1855	1245	189	1405
Aktivitetet sportive	Sektori i Sportit e ka realizuar plan-programin e vetë të punës dhe për periudhën janar-qershor ka zhvilluar këto aktivitete. Në kuadër të planifikimit të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektorit të Sportit janë kryer këto punë – aktivitete sportive: - Janë zhvilluar takime me klubet dhe shoqatat sportive për plotësimin e dokumentacionit-formularëve dhe raportimit të subvencionit; - Pjesëmarrje në komisione të ndryshme vlerësuese të ofertave për projektet e ndryshme në bazë të vendimit të kryetarit të komunës; - Është bërë raportimi i të dhënave në sistemin e Menaxhimit të performancës Komunale për vitin 2020; - Janë zhvilluar garat për Sh.F.M.U-ve dhe Sh.M.L-ta për garat në lojërat Sipas Kalendarit të garave të Federatës së Sportit shkollor për këtë -2021 për Djem e Vajza në këto disiplina: Pingpong, Basketboll, Shah, Vojelboll dhe Futsall; - Janë ndihmuar klubet në transportin e lojtarëve për zhvillimin e Lojërave kampionale, pjesëmarrje në evente të organizuara nga federatat e ndryshme sportive; - Në palestrën sportive „Hysni Jetullahu” janë zhvilluar garat e SHMFU-ve të nivelit Regjional nga Federata e Sportit Shkollor në disiplinën e Hendbollit;							

- Me datë 13.06.2021 u mbajt aktiviteti sportiv Kupa e Çlirimit të Republikës së Kosovës 2021 nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës;
- Zyrtari i sportit iu është përgjigjur kërkesave të ndryshme nga klubet tona sportive iu është dhënë përgjigja adekuate në bazë të ligjit për sport, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi;
- Zyrtari i sportit ka ndihmuar dhe prezantuar në mbledhjet, kuvendet e mbajtura nga klubet sportive, në seanca stërvitore dhe ndeshje kampionale të zhvilluara gjatë këtij gjashtë mujori;
- Në bazë të kërkesave është dhënë në shfrytëzim Stadiumi Sintetik sipas rregullores në fuqi për Taksa, Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha;
- Zyrtari i sportit si organ mbikëqyrës ka bërë raportin për pagesën në projektin, “Dekorimi i Qytetit”;
- Me datë 23.06.2021 në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës me mbështetje të Drejtorisë Komunale për Arsim të Komunës Drenasit është zhvilluar aktiviteti sportiv me fëmijët e lindur në vitin 2008 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpikë në të cilin aktivitet morën pjesë 944 nxënës të lindur në vitin e pavarësisë, vitin 2008, gjegjësisht nxënës të klasave të VII, nga ta 419 vajza dhe 525 djem;

Stadiumi Sintetik – Drenas

Raporti gjashtë mujor Janar-Qershor

- Është respektuar vendimi i Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, për manualin për COVID-19 për mos pjesëmarrje të shikuesve gjatë aktiviteteve sportive;
- Është mbajtur turneu në Shigjetari ”Kupa e Çlirimit të Republikës së Kosovës “ nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës;
- Janë mbajtur dy lojë me pagesë nga KF: Drenica-Skenderaj;
- Kemi bërë mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruar për rreth objektit të Stadiumit Sintetik;
- Kemi bërë pastrimin e objektit dhe fushës brenda dhe jashtë Stadiumit Sintetik;
- Janë ndërruar rrjetat e portave të cilat i ka dhuruar KF “Drenasi ”;
- Është bërë pastrimi i fushës nga bora;
- Është bërë mirëmbajtja (krehur) barit sintetik në fushë;

Nr.	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
1.	Janar	32	46	894	-	
2.	Shkurt	128	70.10	4052	-	15
3.	Mars	176	228	5452	-	27
4.	Prill	160	195	5091	-	23

	5.	Maj	142	173.20	5237	-	29
	6.	Qershor	149	163.50	4828	-	16
		Përmbledhje e aktiviteteve	787	876.20	25554	-	110
	Palestra e Sportit “Hysni Jetullahu” – Drenas Raporti vjetor Janar-Dhjetor						
	Nr	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
	1.	Janar	18	31	190	-	1
	2.	Shkurt	85	167	1247	-	7
	3.	Mars	60	116	1241	-	9
	4.	Prill	55	101	1189	-	10
	5.	Maj	87	180	2044	-	6
	6.	Qershor	51	81	684	-	1
		Përmbledhje e aktiviteteve	356	676	6595	-	34
Aktivitetet rinore	Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL-në gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete: - Janë mbajtur zgjedhjet e rregullt për zgjedhje të strukturës udhëheqëse të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, ku për një mandat të dytë u zgjodh edhe për një mandat Donika Zogu; - Realizimi i takimeve me strukturat e KVRL-ës; - Realizimi i trajnimeve në disa fusha më të rinjtë e komunës sonë; - Shënimi i ditës botërore të pastrimit;						
	Në kuadër të projekteve kapitale në gjashtëmujorin e parë të 2020 kemi pasur pengesa në realizimin e tyre për shkak të pandemisë, por prapë ka pasur zhvillim të punimeve kështu kemi këto projekte të zhvilluara në këtë periudhë: - Vazhdimi i ndërtimit të Stadiumit “Rexhep Rexhepi” faza e dytë; - Renovimi i Stadiumit Sintetik, Faza e Parë si projekt kapital; - Ndërtimi i Fushave Sportive dhe Rekreacion; - Renovimi i monumentit natyror “Uji i Thartë” në Poklek, projekt kapital emergjent;						

2.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lëmit përkatëse që janë kompetencë e saj, në bazë të Statutit të Komunës.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të kompetencave , autorizimeve dhe përgjegjësi të saj funksionon në zbatim të drejtpërdrejt të ligjeve:

- ✓ Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L-26 ;
- ✓ Ligji për mbrojtjen e bimëve Nr. 02/L-95 ;
- ✓ Ligji për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr.04/L-74 ;
- ✓ Ligji për Gjuetinë Nr.02/L-53;
- ✓ Ligji për Bletarinë Nr.03/L-111 ;
- ✓ Ligji për kujdesjen ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- ✓ Ligji për pyjet e Kosovës Nr.2000/3 ;
- ✓ Ligji 03/L-153 , për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës .

Në komunën e Drenasit bujqësia po shndërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe duke marr parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në atë klimatik . Komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetet në zhvillimet bujqësore ku nëpërmes saj do të hapen vende të reja të punës e po ashtu si qëllim kryesorë do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

➤ **SEKTORI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL KA KRYER KËTO PUNË :**

- Regjistrimi i fermerëve të ri në regjistrin e fermës;
- Janë lëshuar certifikata të fermerëve (NIF-i dhe ANEKS-i);
- Janë dhënë këshilla direkte për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë posaçërisht për ata fermer që kanë; qenë të interesuar për aplikim për grantet e publikuara nga MBPZHR si dhe për projektet e Drejtorisë;
- Shpërndarja e broshurave për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë;
- Pranimi , shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve dhe kthimi i përgjigjeve;
- Përgaditja e Projekteve të propozuara për vitin 2021 nga DBPZHR;
- Dalja në terren në bazë të kërkesave të fermerëve për vlerësimin e dëmeve në kultura bujqësore;
- Raporti Vjetor 2020 si dhe Plani i punës për vitin 2021 janë përfunduar, protokolluar dhe janë publikuar në ueb faqe të komunës që të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit;
- Është hapur thirrja publike për aplikim për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë;
- Janë plotësuar të dhënat e kërkuara nga DBPZHR për Planin gjithëpërfshirës të komunave;
- Janë kompletuar dokumentet e kërkuara nga Komisioni për vlerësimin e raporteve të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020. Këto dokumente shtesë nuk janë kërkuar më parë për lëndët e dorëzuara për kompensim;
- Komisioni për vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore – vërshimet në lëmin e bujqësisë ka pranuar kërkesat e fermerëve që kanë pasur dëme dhe janë duke bërë vlerësimin e dëmeve;
- Pas alokimit të mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime kemi bërë kërkesat për pagesa të faturave të papaguara;
- Është bërë pranimi i aplikacioneve të fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020;
- Është bërë raporti mujor nga qendra këshilluese për Qendrën Informuese Këshilluese;

- Punim në Zbatimin e Strategjisë së zhvillimit Ekonomik;
- Është punuar në dy projekte të Drejtorisë në Sera dhe Makina Mjelëse dhe janë dorëzuar në prokurim për zhvillim të procedurave të mëtutjeshme ;
- Po ashtu në kuadër të drejtorisë është bërë azhurimi i lëndëve në mënyrë elektronike;
- Është punuar në thirrjet publike për projektet e publikuara në prokurim (Sera dhe Makina Mjelëse dyshe);
- Janë publikuar thirrjet publike për dy projektet të drejtorisë (Sera dhe Makina Mjelëse dyshe);
- Janë dhënë këshilla fermerëve për plotësim të aplikacioneve për projektet e drejtorisë si dhe për komplementim të dokumentacionit për aplikim për këto projekte ;
- Pas alokimit të të hyrave vetanake është bërë zotimi i mjeteve prej 70% për projektin e Makinave Mjelëse;
- Janë dorëzuar në MBPZHR aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020;
- Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për projektin e makinave mjelëse dhe për projektin e Serave 2021 kanë filluar vizitat në terren për të verifikuar gjendjen faktike të aplikuesve për këto dy projekte;
- Pas alokimit të të hyrave vetanake është bërë zotimi i mjeteve për të përfunduar pagesën e faturës për projektin e serave 2020, pagesë kjo që ka mbetë e papaguar për arsye të mos certifikimit të pagesës në sistem elektronik;
- Janë bërë kërkesat për zotime për pagesa të faturave për shpenzimet e drejtorisë.
- Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për projektin Makina Mjelëse ka përfunduar vizitat në terren të të gjithë aplikuesit dhe janë duke e bërë vlerësimin e aplikacioneve në bazë të kriterëve të përcaktuara me thirrje publike, dhe ka rekomanduar listën e fermerëve përfitues dhe jo përfitues zyrës së kryetarit për marrjen e vendimit;
- Është bërë zotimi i mjeteve për projektin e serave, mjete këto të alokuara nga të hyrat vetanake;
- Është publikuar lista e fermerëve përfitues dhe jo përfitues të projektit makina mjelëse dyshe;
- Kemi plotësuar dhe dorëzuar në zyrën e informimit të dhënat e kërkuara nga INDEP për plotësimin e platformës online të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ);
- Është përfunduar participimi i 68 fermerëve përfitues për projektin e serave si dhe është bërë lidhja e kontratave ndërmjet fermerëve përfitues dhe DBPZHR;
- Shpërndarja e makinave mjelëse e paraparë të bëhet me datën 07/05/2021 nuk është bërë për arsye se komisioni për pranim teknik të makinave mjelëse për vitin 2021 ka kthyer mbrapsht pajisjet pasi që operatori i cili ka fituar tenderin nuk i ka sjell pajisjet në bazë të specifikave të kërkuara në projekt;
- Pas përfundimit të participimit të 68 fermerëve përfitues për projektin e serave lëndët janë kompletuar dhe

janë dërguar në financa për alokim të mjeteve;

- Komisioni për pranim teknik datë 14/05/2021 ka bërë shpërndarja e makinave mjelëse pasi ka konstatuar që pajisjeve janë sjellë sipas specifikave të kërkuara në projekt;
- Pas shpërndarjes së makinave mjelëse komisioni ka bërë raportin e pranimit teknik si dhe shpërndarjes së makinave mjelëse;
- Nga furnitori është sjellë fatura për pagesë të makinave mjelëse dhe lënda është kompletuar dhe dorëzuar në zyrën e prokurimit nga menaxheri i projektit për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme;
- Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për projektin e Serave 2021 kanë përfunduar vlerësimin dhe shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve dhe kanë bërë vlerësimin për secilin aplikues në bazë të thirrjes publike dhe rregullores për ndarjen e subvencioneve;
- Është përfunduar participimi i 40 fermerëve përfitues për projektin makina mjelëse si dhe është bërë lidhja e kontratave ndërmjet fermerëve përfitues dhe DBPZHR, janë kompletuar këto lëndë dhe dy dosje fizike janë dorëzuar në drejtorinë e financave për të u përcjellë pastaj për thesar;
- Është rekomanduar për zyrën e kryetarit lista e fermerëve përfitues/jo përfitues për marrje të vendimit, pas marrjes së vendimit është bërë publikimi i listës së fermerëve përfitues/jo përfitues të projektit të serave;
- Janë plotësuar të dhënat për performancë komunale, përkatësisht në fushën e barazisë në punësim dhe në fushën e përfaqësimit gjinor dhe të njëjtat janë përciellur të skanuara përmes emailit dhe janë dorëzuar një kopje fizike;
- Plotësimi dhe dorëzimi i aktiviteteve të Planit Lokal të Veprimit për vitin 2020;
- Është bërë raporti përfundimtar i fermerëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike dhe janë dërguar në MBPZHR.;
- Është bërë përpunimi i lëndëve për dorëzim në arkiv për projektin e makinave mjelëse;
- Më kërkesë të MBPZHR kemi punuar në formularin në të dhënat e kërkuara për korrigjimin e raporteve të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare gjatë muajit korrik-dhjetor 2020;
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellave pranverore për vitin 2021 dhe është përcjellë në MBPZHR;
- Është bërë dorëzimi i lëndëve fizike në arkivin e komunës të projektit e makinave mjelëse;
- Përpunimi i lëndëve të projektit të serave, dhe dorëzimi në arkiv;
- Është bërë dorëzimi i lëndëve nga fatkeqësitë natyrore për qershor në MBPZHR.;
- Është punuar dhe është bërë dorëzimi i planit për bujqësi në dy gjuhë në disa ambasada për ndihme dhe bashkëpunim në sektor të ndryshëm të bujqësisë;
- Është bërë zotimi i mjeteve për projektin e serave ritenderim;
- Punime në Komisione të ndryshme Komunale (Dalje në teren , Përgatitje të raporteve , Dorëzime të lëndëve);

- Nxjerrja e statistikave rreth tokave Bujqësore në Komunën tonë dhe punim i statistikave në sektorët e Bletarisë dhe në Perimekulturë – sipërfaqet e mbjella në ambiente të mbyllura (serra) në Komunën tonë;
- Me kërkesën e zyrës së prokurimit për auditorët e jashtëm është dorëzua lista e projekteve dhe vlerat e paguara të projekteve të zhvilluara gjatë vitit 2020 si dhe auditorëve të jashtëm ju kemi përgjigjur dhe kemi sqaruar çdo paqartësi rreth përzgjedhjes së përfituesve në Projektin e serave 2020 ;
- Pas vendimit për formimin e komisionit për fushatën e Korrje-Shirjeve , në bazë të propozimit nga MBPZHR kemi nxjerrë Aktvendim mbi lartësinë e çmimit të shërbimeve të korrje-shirjeve në Komunën e Drenasit;
- Është formuar komisioni për korrje-shirje që të bëjë përcillje dhe realizimin e korrje-shirjeve në territorin e komunës së Drenasit;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe dërgimi në Qendrën Informuese Këshilluese “QIK”;
- Vizitë në Ibër Lepenc – Prishtinë për kërkimin e hartave të zonave ku shtrihet sistemi i ujitjes;
- Punime në plotësimin e të dhënave për integritetin dhe menaxhimin e rrezeve për TM4 /2021;
- Plotësim i formularit – Studim mbi Ndikimin Socio-Ekonomik të COVID -19;
- Azhurimi i lëndëve në mënyrë elektronike në kuadër të DBPZHR-së;

MBROJTJA E PYVEVE

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 stafi i njësisë është angazhuar për menaxhim, sa më të mirë të mbrojtjes së pyjeve dhe parandalimin e prerjeve ilegale, parandalimin e sëmundjeve patologjike si dhe është e angazhuar për parandalimin e zjarreve gjatë zezonës së verës duke ju referuar gjithnjë Planit Menaxhues vjetor të cilin e kemi paraparë për Vitin 2021 dhe realizimi i tij. Dëmet pyjore në pronën publike Janar-Qershor-2021

Gjatë kësaj periudhe në Gjykatë janë ngritur:

- | | | | |
|---------------------------------|---|--------------------------------|--------------|
| a. Fletëparaqitje kundërvajtëse | 4 | Copë në sasi 6.97 m3 në vlerë | 891 Euro. |
| b. Fletëparaqitjet penale | 3 | Copë në sasi 61.42 m3 në vlerë | 7,168. Euro. |
| Gjithsej: | 7 | Copë në sasi 68.39 m3 në vlerë | 8,059. Euro |

Seanca Gjyqësore të mbajtura Janar-Qershor 2021

- | | |
|-----------|--------------------------------------|
| a. | 4 seanca të karakterit penal |
| b. | 0 seanca të karakterit kundërvajtës. |
| Gjithsej: | 4 lëndë. |

Vendimet e shqyrtuara nga Gjykata për periudhën Janar-Qershor 2021

- | | | |
|------------|-------|--|
| a. | Lëndë | 12 penale të shqyrtuara në favort të Autoritetit Pyjor |
| b. | Lëndë | 0 penale të pezulluara |
| c. | Lëndë | kundërvajtëse |
| d. | Lëndë | 8 e pezullueme kundërvajtëse |
| Gjithëset. | | 20 copë |

Konfiskime të druve Janar-Qershor 2021

- a. Janë konfiskuar 3.54 m3 dru transport ilegal.

Zjarret Janar-Qershor 2021

a. 0

Pyllëzimet Janar- Qershor 2021

- a. Pyllëzime nuk kemi patur përveç të parapara për pyllëzime vjeshtore:

1. Damaneku, Verboc dhe të Kisha në Llapushnik

Damkosja në pyjet publike Janar-Qershor 2021

- a. Ndërhyrje silvikulturore teknike do të kemi në Baicë dhe G.Gashit.

- b. Baicë 10 hektarë rrallime paratregtare.
c. Gryka e Gashit 10 hektarë rrallime paratregtare
d. Zonja e Maleve –Vasilevë 40 ha të parapara për shitje me pakicë

Gjithsej: 60,00 hektarë

Pyjet private Janar- Qershor 2021

- a. Kërkesa të sektorit privat ishin 8

Të shqyrtuara . 1

Kontrolla pyjore në tri objektet pyjore Janar – Qershor 2021

- a. Inspektive pyjore janë kryer 4 me polici dhe punëtorë
b. Kontrolla tregu janë kryer 2 me polici dhe stafë, inspektorë.
c. Kontrolla pyjore të rregullta 35 me punëtorë

Gjithsej : 41 kontrolla

Regjistrimi i dëmeve pyjore në pyjet publike.

- a. Regjistrimi i objektit pyjor të kryer i“QYQAVICËS”- pranim-dorëzim

Gjithsej: Një objekt (1). Regjistrimet ishin të rregullta siqë janë më ligj.

Shtesë

- a. Komisione të ndryshme të kryera sipas kërkesave.
Komisione - 2 detyra shtesë jashtë sektorit të pylltarisë
b. Komisione- 4 detyra të cilat i kemi obligative në APK.
Gjithsej: 6 Komisione të ndryshme

Të hyrat nga taksat Janar- Qershor 2021

- a. Taksa në pyje private 121,00 Euro
b. Taksa të hyra nga dëmet pyjore shtetërore 00 Euro
c. Të hyrat nga taksat për bagëti 00 Euro
d. Të hyrat nga prerjet sanitare të pishave .00 Euro.
e. Të hyrat nga drutë e konfiskuara .00 Euro
Gjithsej: 121.00 Euro.

Kurse nga gurët dhe zhavori nga gurorët në teritor të Komunës 30% mjete
Ndahen nga Buxheti i Konsolidim i Kosovës për Komuna, pjesa tjetër në
Agjensionin Pyjor të Kosovës. Për këto të hyra 30% njoftohet Drejtoria për
Buxhet dhe Financa.

Dorëzimi në Gjykatë i Aktgjykimeve për plotëfuqiahmërinë.

- a. 19 copë Aktgjykime

Dorëzimi i lëndëve të përmbaruesi privat:

a. 17 copë Aktgjykime

Punët dhe detyrat e stafit dhe vështirësitë në punë- Janar- Qershor 2021

Njësia e Autoritetit Pyjor Komunal ka kryer punë dhe detyra sipas Planit vjetor 2021 të paraparë sipas Planit për të i realizuar brenda mundësive që ka ky staf dhe rrethanat në punët dhe detyrat të cilat i kemi paraparë dhe pranuar sipas Ligjit për shërbyesit civil ju njoftojmë se Njësia e Autoritetit Pyjor Komunal angazhimin kryesor e ka të orientuar në mbrojtjen dhe parandalimin e prerjeve ilegale dhe mbrojtjen kundër zjarreve gjatë sezonës së verës dhe kundër smundjeve të ndryshme patologjike. Gjatë regjistrimit të dëmëve pyjore punëtorët-rojtarët e pyellit kanë qenë në nivel të detyrave ku revizionet të Qyqavicës të bëra për pranim dorëzim të objektit pyjor të “Qyqavicës”. Organizimi me Polici është në nivele të lartë. Po ashtu edhe me Gjykatë kemi bashkëpunim të ndërsjellët.

2.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyqe në periudhën janar-qershor 2021 për realizimin e prioritetëve	Drejtorja e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-qershor 2021 i ka kryer duke u bazuar në planin e punës për vitin 2021. Me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus (COVID-19), Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim dhe asistimin e PK në bazë të Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjit nr.02/1-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Manualit dhe Rekomandimeve të IKShP si dhe në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është duke vazhduar inspektimet e të gjitha subjekteve për të respektuar masat mbrojtëse për mbrojtje ndaj COVID-19. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe është bërë edhe punë shtesë jashtë orarit të punës. Orari i kujdestarisë është mbajtur ditëve të vikendeve dhe festave e sidomos gjatë muajit mars dhe prill 2021 dhe atë me fokus të veçantë për shkak se në këtë periudhë kanë filluar ndërtimet pa leje e sidomos ditëve të vikendeve dhe festave, si dhe me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus (COVID-19). Gjatë periudhës raportuese janar –qershor 2021 vazhdimisht për çdo ditë pune kanë sjellë raportet ditore të punës, ndërsa nga Shefi i Inspeksionit janë hartuar raportet javore dhe mujore për punët e kryera në këtë Drejtori. Në vazhdimësi janë përcjellë dhe paguar të gjitha obligimet (faturat) për mallra dhe shërbime. Është hartuar buxheti kërkesat fillestare për periudhën 2022-2024 për Drejtorinë për Inspeksion, e po ashtu plani i zotimeve dhe shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime për perioda. Gjatë periudhës janar-qershor 2021 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon : • Inspektimet rreth mbrojtjes nga pandemia COVID-19 sipas Manualit të IKShP, Ligjit për mbrojtje të sëmundjeve ngjitëse dhe Vendimeve të Qeverisë së Kosovës. • Inspektimi i kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazuara dhe të paambalazuara, rreth higjienës dhe kushteve higjieno-sanitare, zbatimit të Ligjit të duhanit etj. • Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet,
---	--

	deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. • Inspektimet e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme. • Inspektimi rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale. • Inspektimi i kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj. • Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.
Nga lëmia e Inspektorit Sanitar	Nga lëmia e Inspektorit Sanitar është bërë inspektimi rreth parandalimit të dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse COVID-19, higjienës së ujit, Institucioneve shkollore, artikujve ushqimor, hoteleve, kuzhinave ushqimore si dhe higjiena e objekteve tjera afariste. • Inspektimet rreth parandalimit COVID-19 ku janë. • Inspektimet rreth higjienës, kontrollës së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe produkteve të përdorimit të përgjithshëm (marketet, subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit etj) • Inspektimet rreth zbatimit të Ligjit për kontroll të duhanit dhe marrja e masave për shkelësit e këtij Ligji. • Inspektimi i ujit të pijes sipas kërkesave të qytetarëve. • Kontrolla rreth librezave sanitare. • Janë bërë 236 inspektime, janë hartuar 86 procesverbale, 714 Aktvendime për izolim dhe 691 aktvendime për anulim (gjithsejtë 1405 aktvendime), 04 pëlqime sanitare, janë shqyrtuar 06 kërkesa të palëve, janë shqyrtuar 07 gjoba mandatore në shumë prej 775.00 euro si dhe 712 lëndë janë proceduar për arkiv.
Nga lëmia e Inspektorëve të Tregut	Nga lëmia e tregut dhe çmimeve për periudhën janar-dhjetor 2020 është bërë inspektimi mbi certifikimin e ushtrimit të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut në Drenas dhe Komoran, orari për fillimin dhe mbarimin e punës së barnatoreve, deklaracioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi. Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve. • Kontrollë rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve. • Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. • Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me MTI-në në bazë të Ligjit të Tregtisë së Brendshme. • Janë bërë 105 inspektime, janë hartuar 78 procesverbale, janë lëshuar 06 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë, 03 konfiskimet mallit, është shqyrtuar 01 gjobë mandatore në shumën prej 70.00 € si dhe janë shqyrtuar 06 kërkesa si dhe janë mbyllë 48 lëndë. • Inspektim për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse ,manualit dhe rekomandimeve të IKShP ,si dhe në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit	Nga lëmia e ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm ndërsa për shkelësit e ligjit janë marrë masat e nevojshme. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, instalime elektrike shtyllat e betonit sipas projekteve nga KEDS, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, rrugë të dëmtuara etj. Gjatë kësaj periode ka pasur një vllug të ndërtimeve ku çdo herë janë zhvilluar procedurat rreth pajisjes me leje ndërtimi, ku problem në vete paraqet definimi i pronave, për shkak të problemeve rreth trashëgimisë dhe bëhen vonesa për tu pajisur me leje, ndërsa problemet më të mëdha janë paraqitur për shkak të tentimeve për ndërtim në zonat e komasacionit dhe nën ujtitje ku nuk lejohet ndërtimi. Për këtë shkak është bërë ndërprerja e punimeve të shumë objekteve në këto zona për investitorët që kanë filluar ndërtimet dhe janë nën mbikëqyrje të inspektorëve. Për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhrat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese si gjoba mandatore dhe kallëzime penale. Gjatë kësaj periudhe janë bërë: • Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore. • Inspektimi i lejeve të ndërtimit • Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike). • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). • Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale. • Gjatë kësaj periudhe janë bërë 252 inspektime, janë hartuar 76 procesverbale, 65 Aktvendime për pezullim të punimeve dhe të ngjashme, 03 kallëzime penale, 18 kërkesa, 14 urdhra për ekzekutim (në procedurë për konfirmim), 11 gjoba mandatore në shumë prej 14.500.00 euro..
Nga lëmia e Inspektorit të Mjedisit	Në lëmin e mjedisit gjatë kësaj periudhë Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave. Gjatë kësaj periudhe është bërë: • Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike. • Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime. • Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të mjedisit. • Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj-sidomos në zonat rurale. • Gjithsejtë janë bërë 53 inspektime, janë hartuar 49 procesverbale, janë shqyrtuar 32 kërkesa, janë shqiptuar 9 gjoba mandatore. • Shuma totale e gjobave është :1110 €
	Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për transportin rrugor dhe Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem i vazhdueshëm është edhe më tutje i kombi-taxive që me gjithë

Nga lëmia e Inspektorit të Komunikacionit	punën që është bërë nga Inspeksioni dhe PK-ës ende operojnë në mënyrë ilegale. Janë inspektuar Operatorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit sipas Ligjit për transportin rrugorë Nr.04/L179. Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon: • Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombinueset, autotaxit). • Inspektimi i pajisjes së transportueseve me leje operimi, orar të udhëtimit. • Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë etj, sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësiti në Drenas. • Për këtë janë bërë 139 inspektime, janë hartuar 31 procesverbale, janë konfiskuar 07 parë tabela të regjistrimit, si dhe është iniciuar 01 kërkesë për kundërvajtje për Gjykatë.
--	--

Gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2021 janë realizuar:

-Inspektime.....	785
-Procesverbale.....	320
-Aktvendime për izolim (COVID-19).....	714
-Anulime të Aktvendime për izolim (COVID-19).....	691
-Aktvendime për ndërprerje të punimeve.....	65
-Pelqime.....	10
-Gjoha mandatore.....	28
-Konfiskim malli pa afat.....	03
-Konfiskim i tabelave të automjeteve.....	07
-Kallëzime penale.....	03
-Kërkesa për kundërvajtje.....	01
-Lëndë të proceduara në arkiv.....	772

GJOBAT MANDATORE TE SHQIPTUARA SIPAS SEKTOREVE

1.Sektori Sanitar

-Asgjësim malli dhe mbrojtje nga COVID-19..... 775.00€

2.Sektori i Tregut

-Për moszbatim të orarit të punës..... 70.00 €

4.Sektori i Ndërtimit

-Për ndërtimin e objekteve pa leje ndërtimi.....14.500.00 €

5.Sektori i Mjedisit

-Për hedhje të mbeturinave dhe djegia e tyre.....1.110.00 €

Totali:..... 16.455.00 €

Është mesë e nevojshme plotësimi i vendit të punës me një inspektor të Bujqësisë një të shërbimeve publike si dhe të bëhet rregullimi i kushteve të tregut të gjelbër dhe të kafshëve në Drenas dhe Komoran.

2.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë periodës janar-qershor 2021, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MEF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Kjo drejtori, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

- raporti i punës dhe financiar për vitin 2020,
 - pasqyrat financiare 2020,
 - procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2022-2024, sipas kërkesave fillestare,
 - aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve ,
 - kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raporteve me SIMFK,
 - punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),
 - regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
 - autorizimi i shpenzimeve për D.B.F
 - përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,
 - përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MFPT,
 - caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2021,
 - evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve ,
 - përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
 - raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2021,
 - propozim Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024,
 - shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,
 - plotësimi i formularëve për buxhetin 2022-2024, sipas kërkesave fillestare,
 - Trajnimin e punëtorëve të D.B.F,
 - punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
 - punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.
- 1. Sektori i Buxhetit-** Për periodën janar-qershor/2021, ka kryer këto punë dhe detyra pune:
- zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2022-2024, sipas kërkesave fillestare,
 - Dëgjimet e para buxhetore dhe pranimi i prioriteteve nga fshatrat dhe qendrat Komunale.
 - përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024
 - vërtetime tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit,
 - numër i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal ,
 - lëshimi i fletëpagesave sipas kërkesës së palëve, 12,463,
 - ruajtja e data bazës për të dhënat e regjistruara,
- objektet e reja të matura – rimatura , 914
 - fatura të shpërndara përmes poste 12,463,
 - numër i ankesave të pranuar 5 ,
 - pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja 333,
- 2. Sektori i Thesarit.-** Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periodën janar-qershor /2020, janë kryer si vijon:
- Është bërë arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiqari, arkiv, gjeodezi, urbanizëm, shërbimet e pagesës se tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve-shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
 - regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në data bazë dhe në sistemin e Free-balancit,
 - tansferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MFPT për çdo fund muaji ,
 - barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
 - hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevojat të ekzekutivit dhe MFPT-së,
 - hartimi i raporteve javore për të hyrat vetanake për nevojat të ekzekutivit,
 - zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit,
 - kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtoritë dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara. Vlen të cekët se 100% e lëndëve të pranuar në zyrën e pagesave janë proceduar për pagesë,

- Certifikimi UOP për të gjitha kategoritë: 1.844,
 - Certifikimi i UOP për Komunal 755,
 - Aprovimi i avanseve për para të imta 35,
 - Certifikimi i UOP për mallra dhe shërbime 944,
 - Certifikimi i UOP për Subvencione 45,
 - Certifikimi i UOP për Investime Kapitale 26
 - Certifikimi i UOP për Shpronësime 39
 - Dorëzimi i UOP në arkiv 1,844,
 - përgatitja e analizave javore dhe mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesor dhe programeve.
- 3. Sektori i Financave.-** Në periodën janar-qershor /2021 , përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:
- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin /2020,
 - certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve– drejtorive dhe zyrave komunale me modulën e blerjes,
 - certifikimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit ,
 - përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për 6 muajt e vitit.
 - është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuar sipas shpenzimeve veq e veq,1,844
 - raporti i punës-financiar për periodën Janar-Mars /2021
 - raporti i punës-financiar i periodës janar-qershor/ 2021,
 - plani i punës për vitin 2021,
- 4. Zyra e Tatimit në Pronë**
- Raste të reja 333 ,
 - Verifikim Tereni 581,
 - Lëndë të miratuara intranet 4,946,
 - Fletëpagesa të lëshuara nga arka 17,226
 - Modifikimi i të dhënave të pronës dhe tatimpaguesve 29
 - Regjistrim i tatimpaguesve 274
 - Verifikime Burimore 550
 - Certifikata të pagesës për TPr 6,081
 - Shpronësimet dhe ndërrimet e pronarëve 76
 - Referime kadastrale 30
 - Korrigjime dhe kalkulim manuale të pagesave 1,043
 - Ri programim i marrëveshjeve 13
 - Kontrata shitblerjesh 44
 - Vendime për Korrigjim sipas kërkesave të tatimpaguesve 32
 - Certifikata të tatimpaguesve 6,081,
 - Certifikata për jo tatimpagues 267,
 - Lidhja e marrëveshjeve për pagës me këste 9,
 - Regjistrimi i kontratave të shitblerjeve 18,
 - Ri kalkulimi i relacioneve të reja 30,
 - Shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve 5,
 - Shqyrtimi i kërkesave për korrigjim 11,
 - Lëshimi i faturave në mënyrë manuale 6,081,

Nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periodën raportuese(janar-qershor 2021) , janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa , Kuvendin e Komunës.

2.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**I. DSHMS - Administrata**

DSHMS: Lëndë të pranuar=760, Në proces=260, të miratuara=490, Refuzuara=4, Hedhura poshtë=2, Totali=760.

Kujdesi Parësor Shëndetësor**RAPORTI I PUNËS I QENDRES KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE „Dr.HAFIR SHALA”**


Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, ne bazë të infrastrukturës dhe strukturës organizative ofron shërbime shëndetësore në gjithë territorin e Komunës së Drenasit bazuar në konceptin e mjekësisë familjare. Këto shërbime shëndetësore janë gjithëpërfshirëse për të gjitha grup moshat. Kujdesi shëndetësor në bazë të rrethanave të kohës dhe përparimit të teknologjisë ka një qasje të avancuar në aspektin e trajtimit dhe përkujdesjes shëndetësore, është një kohë e transformimit dhe një qasje gjithëpërfshirëse shëndetësore, mirëqenies sociale, ekonomike, epidemiologjike dhe rehabilituese.

Detyrat e përgjithshme Ligjore dhe statusore të QKMF-së

- Zbaton ligjin për shëndetësi me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve
 - Zbaton politikat shëndetësore të hartuar nga DSHMS të nivelit lokal -
 - Zbaton planin operativ të propozuar nga Kuvendi Komunal përmes DSHMS-le
 - Planifikimi i nevojave për resurse humane profesionale
 - Shfrytëzimi racional i buxhetit të aprovuar nga Kuvendi Komunal në bashkëpunim me DSHMS
 - Organizimin e punës në kujdesin parësor shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore profesionale dhe cilësore
 - Përmes protokolleve dhe udhërrëfyesve klinik përcjell trendin e trajtimit të sëmundjeve dhe diagnostikimit
 - Zbaton udhëzimet administrative për kujdes parësor të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë
 - Vlerëson nevojat lokale në bazë të të dhënave dhe parashtron DSHMS-le për hapat e veprimit
 - Raporton për situatën epidemiologjike DSHMS –le në mënyrë që të monitorohen situatat nga DSHMS-le.
 - Bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare që kanë për qëllim përparimin e shëndetit
- Në kujdesin parësor shëndetësorë.

48

QKMF - DRENAS



Struktura e Trupave Profesionale të QKMF-së / Drenas 2021

Nga Organogrami i mësipërm shohim strukturën organizative edhe të Trupave profesionale QKMF

Ndërsa nga numri i përgjithshëm i stafit të certifikuar është 181 që është në funksion të organizimit, ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe stafi mbështetës jo shëndetësor administrativë dhe logjistik në bazë të nevojave dhe detyrave të punës. Në krahasim me 6 mujorin e fundit të vitit 2020, numri i mjekëve në kujdesinë parësor gjatë këtij 6 mujori të parë 2021 ka qenë i zvogëluar për 19 (22) dhe jemi në përpjekje përmes proceduarve të rekrutimit sipas U.Adm. 08/2017 në mënyrë që të arrihet standardi 1 Doktor në 2000 banorë, qëllim i politikës shëndetësore të paraparë me planifikim nga DSHMS.

Burimet njerëzore në QKMF

STAFI I PËRGJITHSHËM I ANGAZHUAR NË SISTEMIN E KPSH-SË									
MP dhe Specialist	Stomatologë	Farmacist	Infermierë	Kadër i mesëm mjekësor	Administratë	Shoferë	Staf mbështetës	Shërbime të Blera	
								Mjekë	Inf.Shof
28	3	1	75	27	8	5	15	0	0
162								0	
162									

Tabela 1.

Numri i përgjithshëm i resurseve humane angazhuar në KPSH

Sipas tabelës numri i mjekëve specialist dhe mjekë të përgjithshëm është 28, stomatolog 3, farmacist 1, infermier 75, kadër i mesëm mjekësor 27 administratë 8, shofer 5, staf logjistik 15. Shërbime të blera 0 zero të angazhuara në shërbime të shëndetit palativ. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare së bashku me njësitë e saja përmbushë pothuajse 80% të shërbimeve shëndetësore të qasshme dhe cilësore për komunitetin. Rrjeti shëndetësor është i dizajnuar dhe i zbatueshëm në bazë të nevojave të komunitetit, ku distanca e secilës njësi është më e shkurtër se 10 km e që arritshmëria duke ju falënderuar infrastrukturës rrugore që ka komuna e Drenasit është për një kohë më të shkurtër se 7 minuta (max.110-12 min.) në dhënien e vizitës dhe tretmanit shëndetësor.

Reforma institucionale dhe përmirësimi i praktikës menaxhuese në sistemin shëndetësorë / prioritetet e përcaktuara rezultojnë pozitivisht në këto elemente:

- 1.. Zhvillimi i konceptit të qasjes në mjekësinë familjare;
2. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare;
3. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë maternale (para, gjatë dhe pas lindjes);
4. Ulja e nivelit të incidencës dhe ndikimit të sëmundjeve ngjitëse duke përfshirë TBC dhe HIV / AIDS;
5. Ulja e nivelit të pirjes së duhanit;
6. Stabilizimi i incidenteve me ndikim në sëmundjet mentale;
7. Zvogëlimi i incidencës me ndikim në sëmundjet kardiovaskulare;
8. Përmirësimi i gjendjes me barëra esenciale;
9. Përmirësimi i menaxhimit të financave dhe prokurimit në sektorin e shëndetësisë;
10. Përforsimi i kornizës ligjore dhe rregullative.

Vizitat dhe shërbimet mjekësore ne QKMF dhe njësitë organizative:

Ne bazë të të dhënave statistikore dhe vëllimit të punës në periudhën Janar–Qershor janë evidentuar **77391** vizita mjekësore; **141971**-shërbime mjekësore e që në total vizita dhe shërbime **21936**. Nga tbl. e mëposhtme këto të dhëna na tregojnë 64.86 % e vizitave mjekësore janë realizuar ne QKMF Drenas, 32.074 % në QMF Komoran, 1.48 % QMF Arllat, 0.23 % QMF Tërstenik, 1% QMF Gllanasellë, 0.2% AMF Baicë/Tërdec, 0.21% AMF Dobroshec, 0.038 % AMF Nekoc dhe 0.027 % AMF Gradicë.

Ndërsa sa I përket Shërbimeve Shëndetësore sipas Institucioneve KPSH kemi këtë situatë: QKMF Drenas gjithsej sh/sh = 99499 (70 %), QMF Komoran sh/sh =38942 (27.4%) dhe gjitha të tjerat sh/sh=3530 (2.48 %). Kjo shpjegohet bazuar në: 1. Situatën Epidemiologjike lidhur me COV-19 dhe 2. Shkuarja e 19 (22) doktorëve ne specializim ne këtë 6 mujor/2021. Situata Epidemiologjike dhe Vendimet e Qeverisë RK si dhe rekomandim të IKSHP Kosovës, qasja ne shërbime shëndetësore gjatë kësaj periudhe është organizuar kryesisht e bazuar në rekomandimet IKSHP dhe Shtabit Operativ të Komunës së Drenasit ne mbikëqyrje të DSHMS .

NrR	KPSH	Nr.Vizitave	%	Nr.Shërb.	%	Totali:	%
1	QKMF Drenas	50201	64.866716	99499	70.084031	149700	68.24336
2	QMF Komoran	24823	32.074789	38942	27.429545	63765	29.06839
3	QMF Arllat	1153	1.4898373	1296	0.9128625	2449	1.116419
4	QMF Tërstenik	183	0.2364616	693	0.4881279	876	0.39934
5	QMF Gllanasellë	676	0.8734866	415	0.2923132	1091	0.497351
6	QMF Baicë/Tërdec	134	0.1731467	880	0.6198449	1014	0.46225
7	AMF Nekoc	30	0.0387642	16	0.0112699	46	0.02097
8	AMF Sankoc	0	0	0	0	0	0
9	AMF Poklek-Vasilevë	0	0	0	0	0	0
10	AMF Dobroshec	170	0.2196638	227	0.1598918	397	0.180979
11	AMF Abri Ep.	0	0	0	0	0	0
12	AMF Gradicë	21	0.0271349	3	0.0021131	24	0.010941
Totali:		77391	100	141971	100	219362	100

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore 24 orë në QKMF Drenas dhe QMF Komoran në kohë pandemie ka ndikuar në qasje të lehtë për kërkuesit e shërbimeve shëndetësore si dhe rritje e numrit të vizitave e shërbimeve në QMF Komoran (29.1%) dhe zvogëlim i lehtë vëllimorë në QKMF Drenas (68.2%).

Sëmundshmëria (morbidity): Në këtë diagram është pasqyruar morbiditeti (sëmundshmëria) në bazë të diagnozave të nxjerra nga SISH të raportuara nga shërbimet përkatëse. Problemet më të shpeshta në bazë të diagnozave janë ato të sëmundjeve të Sistemit respirator (frymëmarrjes), e që të shprehura në përqindje nga numri i përgjithshëm i diagnozave radhitë:

1..Patologjitë e sistemit respirator	23.73%
2. Sëmundjet e sistemit digjestiv	8.5%
3..Sëmundjet e sistemit osteomuskular	10,0 %
4. Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	7.8%
5. Sëmundjet e sistemit urogjenital	5.7%
6. Sëmundjet e sistemit të gjëndrrave me tajim të brendshëm (diabeti)	4.7%

Në bazë të raporteve të diagnozave sëmundjet e sistemit respirator kanë një përqindje më të lartë që përfshin moshat mesatare dhe të shtyera si shkaktar përhapja e pandemisë COVID19 që këto gjendje shëndetësore janë shprehur dhe rastet të diagnostifikuara dhe të dyshuara për COVID 19 me etiologji virale

Sëmundjet e sistemit kardiovaskular që është i shprehur 7.8% paraqet një problem shëndetësor në rritje për arsye të mungesës së aktiviteteve, stresit, trendit të jetesës dhe ushqimit kalorik.

Sëmundjet e sistemit osteomuskular janë të shprehura me 10.0% e që përfshinë moshat mesatare të popullatës me një dekurs kronik si pasojë e trendit të jetës.

Kujdesi ndaj të moshuarve dhe kujdesi paliativ :

Kujdesi ndaj të moshuarve dhe paliativ ka qenë një sfidë në gjashtëmujorin e parë e besojmë se në pjesën e dytë të këtij viti të stabilizohet e bile edhe të zgjerohen shërbimet e kësaj natyre edhe në kategori tjera duke pas parasysh kontratën për shërbime të blera bazuar në planin komunal të Veprimit në IKPSH/ Drenas (Aktivitetet 1.2.4. bazuar në Objektivin e përgjithshëm (që ka të bëjë me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, sigurisë së shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme dhe lehtësisht të qasshme për të gjithë banoret) si dhe Objektivin specifik 1 (për shërbime cilësore, të qasshme të cilat i'u përgjigjen standardeve shëndetësore për nevojat e komunitetit).

Mungesa e qendrave rehabilituese për këto kategori në realitet është barrë e KPSH që ka një kosto të lartë buxhetore për një përkushtim të gjatë kohor.

Efikasiteti i këtij shërbimi është mbuluar me veprimet të shtuara rasteve në dhënien shërbimeve e ndihmës në vendin e ngjarjes si dhe rasteve emergjente duke transportuar konform standardeve në SHKSUK në QE. Transportimi i këtyre rasteve është bërë me urdhëresë të mjekut në njësinë e urgjencës ose të mjekut familjar në raste kur është paraparë nga mjeku se një shërbim i tillë është i domosdoshëm për pacientin.

Situata Epidemiologjike me COVID-19 nga Marsi 2020 deri më 30 Qershor 2021:

Gjithsej raste TEST POZITIVE SARS-COV-2	1878	100%
Gjithsej raste AKTIVE SARS-COV-2	1	0.05%
Gjithsej raste te SHERUARA	1806	96.17%
&EX&	71	3.78%

**Raport Permbledhës I Testimeve Serologjike specifike
në virusin SARS-CoV-2**

**për periudhën Dhjetor 2020 -
Maj 2021 dhe**

**Testimet Rapid - strishoja nazofaryngeale spec. në virusin SARS-CoV-2
Prill 2021 në Qytetarët e Komunës së Drenasit**

Nr.Personave dhe përfshir.	Ig G +	%	IgM +	%	IgG+/ IgM+	%	Gjithse j Test +	%	Gjithse j Test -	%	Tot ali:
3980 persona/Dhjetor 2020-Prill 2021 me teste Serologjike COVID-19	16 40	2 0. 6	1507	18. 9	1082	1 3. 6	4229	53.1	3738	46. 9	796 7
Testet Pozitive / Negative	16 40	3 8. 7	1507	35. 6	1082	2 5. 5	4229	53.0	3738	46. 9	796 7
Rapid Testet - strisho nazofaryngeale			Gjithsej të Testuar:		Rap. Teste		32	6.70 8595	445	93. 291 4	477

Vizitat nga programi; Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri në 3 vjeç.

Për shkak të Pandemisë COVID19 ky program një kohë është ndërprerë dhe ka pasur ngecje në realizimin e kënaqshëm të këtyre vizitave por gjatë kësaj kohe janë dhënë këshilla përmes telefonit nga ana e stafit shëndetësor.

Njësia e Shëndetit Publik – Vaksinimi kundër COVID-19

Janë bërë përgatitjet e nevojshme në harmoni me Komitetin për Vaksinim të MeSH dhe kemi vaksinuar deri 30.06.2021 gjithsej: 4675 të Vaksinuar (prej tyre: Astra Zeneka doza e I-rë=1111 – doza e II-të=318 / Pfizer doza e I-rë=2757 – doza e II-të=489) /// Saldo: Astra Zeneka=1050 doza dhe Pfizer=489.

Barnatorja Qendrore

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor është bërë nga MSH dhe të hyrat vetanake nga buxheti DSHMS. Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësorë nga MSH nuk ka qenë i mjaftueshëm në bazë të kërkesave për shërbime bazike shëndetësore dhe nevojave të pacientëve prandaj shumicën e barnave pacientët i kanë blerë. Arsyeja ka qenë mungesa e furnizimeve nga LEB në krahasim me nevojat reale.

II. QPS – Shërbimet Sociale

Kategoria		Të bartur nga 2021	Levizja e lëndëve gjatë 6M		Lende që bartën Per periudh.
			Të reja	Te mbyllura	
1.	1.a-Fëmijët e braktisur	13	2	-	15
	1.b-Fëmijët jetim (pa dy prinder)	6	1	-	7
	1.c-Fëmijët e prindërve të penguar në kryerje të detyrave prindore	11	2	1	12
	1.d-Fëmijët të strehuar ne Familje Strehuese SOS-fshatin	1	/	1	1
2	Familje Strehuese	1	1	-	1
3	Kërkesa për Adoptim vendor	/	-	-	/
4	Kërkesa për Adoptim Nderkomb.	/	-	-	/
5	Fëmijë të keqtrajtuar	7	8	1	14
6	Fëmijët me sjellje asociale	7	8	3	12
7	Të miturit në konflikt me ligjin	9	3	-	12
8	Viktimat e dhunës familjare	20	18	2	36
9	Viktimat e Trafikimit	2	3	-	5
10	Viktimat e Krimeve seksuale	4	/	-	4
11	Martesa e të miturëve	/	2	2	/
12	Punë të rënda(rrezikshme)te fëmijëve	/	/	-	/
13	Kërkues të këshillimit martesor	21	4	-	25

14	Të moshuarit		8	1	-	9
15	Kl. Tjerë:	1.a-Nënat vetushqyese	15	3	-	18
		2.b-Persona me aftësi të kufiz	13	3	-	16
		3.c-Pers. me aft. kufiz. me pa	70	10	1	79
		4.d-Dok. Administrative	/	/	-	/
		5.e-Arsye tjera	3	3	-	6
	Gjithësej:		211	72	11	272

SAS > Janar=1090, Shkurt=1154, Mars=1166, Prill=1170, Maj=1187, Qershor=1205 raste / Jan.-Qer/2021

2.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, detyrat e punës kryhen u bazuar në planprogramin e punës, duke u mbështetur në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Në bazë të detyrave që janë realizuar gjatë pjesës së parë të vitit 2021, është përgatitur:

RAPORTI I PUNËS PËR GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2021

Në sektorin e planifikimit jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm të qytetit. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban janë trajtuar brenda afatit ligjor kërkesat dhe janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe leje të ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane. Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman jemi në procesin e shqyrtimit publik të Hartës Zonale të Komunës (HZK), në cilën pas përfundimit të shqyrtimit publik do të procedohet në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vendimin për pëlqim të miratimit të HZK-së. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit të objekteve janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë kontrolluar nga zyrtarët përgjegjës dhe është bërë kontrollimi i tyre paraprakisht. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë i'u kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marrura në harmoni me ligjet ekzistuese. Janë trajtuar kërkesat për banesa, kontrata për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës më më pak se 1 vit. Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Biodiversitetit në qytetin e Drenasit, janë mbjellur lule në qytetin e Drenasit, duke i dhënë kështu qytetit një pamje gjelbëruese dhe reflektim pozitiv për secilin që kalon andej pari.





Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, është implementuar projekti Art n'Trafo në bashkëpunim me KEDS Energy, i cili ka pasur për qëllim shndërrimin e trafove të rrymës në objekte artistike në Drenas. Qëllimi i këtij projekti është që trafostacionet e KEDS të shndërrohen në objekte urbane, duke i dhënë gjallëri lagjeve ku ato janë të alokuara dhe njëkohësisht të mundësohet promovimi i artit dhe artistëve të rinj. Realizimi i Projektit Art n'Trafo ka patur ndikim pozitiv në komunitet.







Është realizuar me sukses procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje në Komunën e Drenasit duke u zhvilluar aktivitetet në vetëdijesimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përgatitjen e broshurave, promovimin e videove vetëdijesuese për qytetaret që të aplikojnë për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Pas këtij procesi të legalizimit të ndërtimeve pa leje në Komunën e Drenasit, të rezultuar si të sukseshëm, USAID, Programi për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, ka përzgjedh Komunën e Drenasit për mbështetje në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Në takimin e mbajtur përfaqësuesit e USAID kanë njoftuar se, bazuar në informatat mbi performancën, rezultatet në procesin e legalizimit, menaxhimin e të dhënave, koordinimin, bashkëpunimin dhe kapacitetet e angazhuara në procesin e legalizimit dhe rezultateve të arritura deri me tani në Drenas, kanë vendosur të përzgjedhin Komunën e Drenasit për mbështetje në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje.













Në gjashtë mujorin e parë të këtij viti është implementuar poashtu dhe projekti Gjellbërimi i hapësirave publike në qytet dhe në shkolla, në të cilën është bërë mbjellja e drunjëve dhe luleve në qytetin e Drenasit, duke gjallëruar dhe zbukuruar hapësirat publike të qytetit.









Punët që janë planifikuar të kryhen në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021

- Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore komunale;
- Vazhdimi i aktiviteteve për realizimin me sukses të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje.
- Përfundimin e miratimit të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2021-2029.
- Përfundimi i projektit Gjelbërimi i hapësirave publike në qytet dhe në shkolla.
- Vendosja e tabelave për emërtimin e rrugëve, vendosja e numrave në hyrje të objekteve;
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave hapësinore komunale me sistemet e GIS-it.

2.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Përpilimi dhe hartimi i Raporteve të Punës nga Institucionet Komunale është prezantim i punës përball transparencës dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve tanë. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka prezantuar në vazhdimësi punën e saj përmes raporteve javore e mujore, të cilat kanë pasqyruar ofrimin e shërbimeve gjeodezike e kadastrale për qytetarët dhe personat tjerë relevant dhe veprimet ligjore administrative për pronën publike duke dëshmuar njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien përballë përgjegjësisë që i takojnë. Raporti i Punës për gjashtë mujorin e parë për vitin 2021, vë në pah rritjen konstante të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve kadastrale ndaj qytetarëve, zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore gjatë përmbushjes së detyrave të punës, trajtimin profesional të kërkesave të palëve, kryerjen e shërbimeve në afat ligjor, ndërmarrjen e veprimeve konkrete për trajtimin e pronës komunale, rritjen e vazhdueshme të të hyrave vetanake, menaxhimin efikas të buxhetit të drejtorisë, etj.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është kompetente dhe përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave kontrolluese. Misioni primar i saj është krijimi i një ambienti ligjor në sferën e kadastrit dhe pronës komunale. Puna e drejtorisë orientohet që përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokës dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme me krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijnjëve të tyre në komunën e Drenasit. Qëllimi i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme, përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës komunale dhe efikasiteti në taksimin e tokave, evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve, shtëpive, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, etj. Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi procedon shfrytëzimin e tokave komunale, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë. Ajo ka bashkëpunim të mirë me institucionet qendrore, konkretisht me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastral të Kosovës si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera në fushën e kompetencave dhe përgjegjësi të saj për subjektet e së drejtës dhe organeve shtetërore, dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë arrijnë që ti realizojnë punët e caktuara.

Organizimi

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Gjeodezisë,
2. Sektori i Kadastrit,
3. Sektori i Pronës.

Në përbërjen e saj ka 9 zyrtarë aktiv

2. Organogrami

Drejtori i DGJKP

Shefi i Sektorit të Kadastërit	Shefi i Sektorit të Gjeodezisë	Shefi i Sektorit të Pronës
Zyrtare kadastrale	Zyrtare për gjeodezi	Zyrtar për pronë
Zyrtare kadastrale	Zyrtare për gjeodezi	
Zyrtare kadastrale		

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë është përgjegjëse për:

- a. zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjene, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative për tokën dhe pronën,
- b. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- c. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- d. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- e. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),

f. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,

g. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,

h. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.

i. inspektimin e sipërfaqës së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,

j. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,

k. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,

l. korrigjimin e regjistrimit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi,

m. azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrimit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,

n. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,

o. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,

p. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,

q. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme,

r. regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të tyre,

s. udhëheqjen me kadastrën etazh të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat,

t. regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave,

u. aktvendimet mbi regjistrimin e servituteve, qirambajtjeve dhe barrave të ndryshme,

v. lëshimin e çertifikatave personave që nuk kanë patundshmëri,

ë. mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave,

x. nxjerrjen e aktvendimeve për miratim ose refuzim të kërkesave,

y. nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara,

z. përgatitjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës,

aa. kryerjen e punëve të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe të institucioneve tjera),

bb. mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna,

cc. zhvillimin e procedurës së eksproprijimit, shpronësimit dhe deeksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës,

dd. trajtimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijimë:

-Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,

-Ndarjen e parcelave,

Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve, Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,

-Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave,

-Përsëritja e kufijve të parcelës,

-Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit,

-Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale,

-Nxjerr konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,

Punët tjera gjeodezike. Ndërsa pas hyrjes në fuqi të udhëzimit administrative MMPH-NR 12/19 të dt.21.11.2019. Sektori i Gjeodezisë nuk kryen shërbime gjeodezike për pronar por kryen shërbime vetëm për nevojat e Drejtorisë dhe Komunës, dhe sipas këtij udhëzimi të drejta për kryerjen e shërbimeve Gjeodezike kanë vetëm Gjeodetët e Licencuar nga AKK.

Gjatë gjashtë muorit të parë vitit 2021 sektori për gjeodezi në tërësi ka zbatuar punët e planifikuara për këtë periudhë të vitit ku me sukses kemi përfunduar këto planifikime. Sektori i Gjeodezisë në vazhdimësi kryen të gjitha këto shërbime gjeodezike sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, si: Sektori i Gjeodezisë ka bërë një angazhim dhe një përkushtim të madhë për të azhuruar autostradën N9 në pjesën grafike dhe në RDPP edhe pse kjo autostrada është shpronësuar në vitin 2009 dhe është dashur të jetë e përfunduar por ka qenë një mos interesim nga Ministria e Infrastrukturas por me insistimin e DGJKP-së që ka bërë ndaj Ministrisë së Infrastrukturas kemi siguruar shenimet e autostradës N9. Është kompletuar dosja për elaboratë për rrugën regjionale për Carralevë, me kërkesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës. Drejtoria ka arritur të bëjë azhurimin e autostradës N9 në pjesën grafike dhe RDPP në të gjitha zonat të cilat janë jashtë masës komostative ndërsa autostrada që kalon në zonat kadastrale që janë masën komostative kemi bërë azhurimin vetëm në pjesën grafike ndërsa në pjesën tekstuale RDPP do të bëhet azhurimi pas përfundimit të komosacionit. Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë ka qenë e angazhuar në ndarjen dhe bashkimin e parcelave të cilat parcela janë dhënë në shfrytëzim afatëgjatë për 99 vite dhe regjistrimin e kontratave të përfituesve në RDPP.

Gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021 Sektori i Gjeodezisë ka trajtuar kërkesat, si në vijim:

-Kërkesa për ndarje të parcelave kanë qenë 162 raste

-Bashkim parcelave 23 raste

-Modifikim i attributeve të parcelave 11 raste

-Regjistrim të ndertesave të legalizuara 16 raste

-Koordinata dhe vektor 106 raste

-Korigjim kufiri të parcelave 64 raste

-Kopje plani gjithësejtë 616 raste

Gjatë realizimit të këtyre kërkesave kemi të hryra **1,840.50 €** nga shërbimet gjeodezike dhe **2,464.00 €** për kopje të planit.

Gjithësejtë të hyra nga shërbimet gjeodezike edhe nga kopjet e planit janë **4,304.00 €**. Gjithësejtë 6 përgjigje kemi kthyer për Gjykatën në Drenas e cila ka kërkuar koordinata, 8 përgjigje për Gjeodet të Licencuar dhe 2 përgjigje për pale. Sektori i Gjeodezisë është i ndërlidhur ngushtë me sektorin e kadastrës dhe është e pamundur të funksionoj njëra pa tjetrën, të gjitha lëndët që fillojnë nga sektori i gjeodezisë dhe pas shqyrtimit dhe përpunimit të këtyre lëndëve aprovohen nga ky sektor dhe pastaj nga pala parashtrohet kërkesa në sektorin e kadastrës për t'i regjistruar në SIKTK-T. Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon me sektorin e pronës si në raste për definimin e pronave komunale, për përcaktimin e kufijve të parcelave, konstatime të ndryshme që janë të uzurpuara pronat dhe marrim pjesë gjatë lirim të pronave komunale për t'i caktuar kufit të parcelave etj. Përveq punëve që kemi në sektorin e gjeodezisë gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme, si:

-Komision për harta zonale.

-Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatëkëqësit natyrore.

-Komisioni për verifikimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpive.

Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon edhe me Drejtoritë tjera për të ndihmuar në realizimin e projekteve, identifikimin e pronave komunale apo kërkesave të ndryshme.

Gjatë periudhës 6 mujore të vitit 2021 kemi panuar nga Drejtoritë e Komunës së Drenasit, **28** kërkesa të ndryshme të cilat janë kryer në një afatë kohor të shpejt me qëllim që të ofrohet lehtësira për realizimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikuar direkt në mirqënjen e qytetarve.

Spektori i Gjeodezisë ka realizuar **46** kërkesa për Sektorin të Pronës të cilat kërkesa janë parashtruar nga administratorët e fshatrave që kryesisht kanë qenë kërkesa për lirim të rrugëve publike dhe pronave komunale.

Kërkesa të ndryshme ka pasur edhe në piketimin e rrugëve publike me qëllim që të bëhet asfaltimi i tyre dhe kërkesa të ndryshme për realizimin e kanalizimeve dhe kolektorve.

Të gjitha keto kërkesa që kemi realizuar për drejtoritë në fjalë ka qënë punë me përgjegjësi dhe është dashtur një përkushtim më i shtuar profesional me qëllim që të jemi sa më të saktë në konstatimet tona.

3.2. Detyrat e Sektorit të Kadastrit

Spektori i Kadastërit brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

- Themelon regjistrin mbi pronën e paluajtshme,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve,
- Bën korrigjimin e regjistrit sipas procedurave,
- Zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës,
- Bën azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor,
- Bën azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga tereni,
- Nxjerr Aktvendime dhe Çertifikata sipas ligjit mbi kadastërin dhe udhëzimeve administrative për kadastër,
- Nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,
- Koordinon punët dhe zbaton udhëzimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 sektori i kadastrit ka kryer kërkesa të ndryshme po shumica dermues e kërkesave kanë qënë për:

Dhënja e çertifikatave të pronës së paluajtshme
 Dhënja e çertifikatave që nuk posedojnë pronë
 Regjistrimin e shitëblerjes së pronës së paluajtshme
 Modifikime atributive të parces
 Modifikime atributive të pjesëve të ndërtesave
 Regjistrimin e ndarjeve të parcelave
 Regjistrimin dhe fshirjen e hipotekave etj.

Spektori i Kadastërit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 ka pranuar, shqyrtuar, regjistruar këto kërkesa:

Lloji i shërbimit	Total
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	119
Bartja e posedimit - Blerje	90
Bartja e posedimit - Dhurim	74
Bartja e posedimit - Këmbim	8
Bartja e posedimit - Shpronësim	14
Bartja e posedimit - Trashëgimi	73

Bashkimi i parcelave	36
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme	21
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme pa njësi	28
Fshirja e drejtës së shfrytëzimit	2
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	30
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	2
Krijimi i kopjes zyrtare te planit	616
Modifikimi attributeve të ndërtesës	6
Modifikimi attributeve të parceles	181
Modifikimi i attributeve të pjesës së ndërtesës	6
Modifikimi i drejtës së shfrytëzimit	13
Modifikimi i hipotekës	9
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	113
Modifikimi i të drejtave	29
Modifikimi i vërejtjes	4
Ndarja	79
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	1
Regjistrimi i hipotekës	53
Regjistrimi i ndërtesës	37
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	5
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	4
Regjistrimi i posedimit të pronës shoqërore sipas detyres zyrtare	14
Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes	7
Regjistrimi i servitutit	0
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	9
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	1
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykates	1
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	1
Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës	1186
Shërbimi i të dhënave / Vërtetim që nuk posedon pronë	640
Shërbimi i të dhënave për personat fizik dhe juridik	27
Totali	3539

Nga të gjitha keto punë të realizuara Sektori i Kadastërit i ka të hyra nga regjistrimi pronave **14,826.50 €**, dhe nga çartifikatat e pronës **4,744.00 €**, gjithsejtë **19,570.50 €**.

3.3. Detyrat e sektorit të Pronës

-Zhvillon procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore,

-Zhvillon procedurat e deekspropriumit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth

shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore,

-Kujdeset për mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Komuna e Drenas-it,

-Udhëheq procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare,

-Mbanë evidence për lëndët e uzurpimeve,

-Kujdeset për procedurat në përputhshmëri me ligjet në fuqi,

-Kryen procedurat e eksproprijimit,

-Nxjerr aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtuara, etj.

Në periudhën raportuese gjegjësisht nga Janari e gjerë në fund të muajt qershor 2021,

Në sektorin e pronës, janë kryer këto punë dhe detyra:

Në tërën janë realizuar 74 kërkesa nga drejtorit e ndryshme të komunës si dhe nga administratorët e fshatrave. Në zyre janë mbajtur takime me palë, si dhe janë kthyer përgjigje në kërkesat të cilat nuk ka pasur mundësi që të kryhen në teren. Është bërë sistematizimi dhe kalsifikimi i dosjeve të sektorit të pronës në foldera të vacant, sipas viteve dhe llojit të dokumenteve. Është krijuar dosja elektronike e dokumenteve të skanuara dhe të evidentuara në formë tabulare e sketorit të pronës. Është bërë identifikimi i parcelave të pronave komunale të cilat janë të uzurpuara nga persona të ndryshëm, me objekte, rrethoja, parkingje, kullosa etj. Kemi pranuar kërkesa për heqje dorë nga Pronësia dhe ti jipet Komunës gjithësejt 2, po ashtu edhe janë përpiluar Deklaratat e Mirëkuptimit dhe janë bërë regjistrimet në RDPP, dhe është bërë bartja nga prona private në emër të KK Glllogoc. Janë përgaditur të gjitha pagesat e kompensimit të pronarëve për pronave e shpronësuar, ku janë kompletuar 99% pagesat, një pjesë e këtyre pagesave është bërë në llogarin e Fondit të Mirëbesimit të Koumnës së Drenasit, ndërsa është mbetur vetëm edhe një pagesë e rregullt për tu bërë për rrugen tranzitore Feonikel - Kroni i Mbretit, si dhe janë paguar 3 prona të cilat janë shpronësuar nga AKP, ku janë bërë pagesa e 20%, në llogarinë për shpronësim të AKP-së. Janë shpallur 7 uzurpator si dhe 1 raste janë ne procedure.

Lëndet e intranetit

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

01/01/2021 - 30/06/2021, Drejtoria: DGJPK

Shkurtesa	Pershkrimi	Pra nuar	Ne Proce s	Mirat uar	Refuz uar	Hedh ur Posht e	Pezullu ar	Cedu ar	Anulu ar	Perfundu ar	Tota li
DGJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	4	25	2286	1	0	0	0	22	0	2338
		4	25	2286	1	0	0	0	22	0	2338

Të hyrat vetanake sipas programeve dhe fushave kryesore të të hyrave të planifikuara për vitin 2021- të hyrat për gjashtë mujin e pare 2021.

Data 16/7/2021
raportimit :

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Koha e raportimit : 13:11:19

Përdorues : ENVERH

Ministria e Financave

Raporti I Analizave të Llogarive - Përmbledhja

Viti Fiskal : 2021 Periudha fiskale : JANAR Periudha fiskale : QERSHOR

Kriteret e filtrimit : Elementet hierarkike të Bllokut kodues - **FUND : OBJ (Nga : 21) (Nga : 21), ORG : UNIT (Nga : 611) (Nga : 611), PROG : SPROG, OBJECT : LITEM (Nga : 40000) (Nga : 60000)**

Grup sipas : Periudha Fiskale

Përshkrim	Periudha	Debiti	Kredit
Valutë : EURO (€)			
65005 - SHËRBIMET KADASTRALE - GLLOGOC		0.00	23,874.50
50011 - TAKSA PËR REGJISTRIMIN E TRASHËGIMISË - NDËRRIMI I PRONARIT		0.00	17,464.00
Bilancet e Hapura		0.00	0.00
Totali për periudhën	1	0.00	1,767.00
Bilanci		0.00	1,767.00
Totali për periudhën	2	0.00	1,342.00
Bilanci		0.00	3,109.00
Totali për periudhën	3	0.00	2,693.00
Bilanci		0.00	5,802.00
Totali për periudhën	4	0.00	2,445.00
Bilanci		0.00	8,247.00
Totali për periudhën	5	0.00	4,123.00
Bilanci		0.00	12,370.00
Totali për periudhën	6	0.00	3,360.00
Bilanci		0.00	15,730.00
50012 - TAKSA PËR NDËRRIMI I DESTINIMIT TË TOKËS		0.00	8,344.50
Bilancet e Hapura		0.00	0.00

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Totali për periudhën	1	0.00	533.00
Bilanci		0.00	533.00
Totali për periudhën	2	0.00	1,734.50
Bilanci		0.00	2,267.50
Totali për periudhën	3	0.00	1,556.00
Bilanci		0.00	3,823.50
Totali për periudhën	4	0.00	1,229.50
Bilanci		0.00	5,053.00
Totali për periudhën	5	0.00	1,366.00
Bilanci		0.00	6,419.00
Totali për periudhën	6	0.00	1,021.50
Bilanci		0.00	7,440.50
50019 - TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE		0.00	193.00
Bilancet e Hapura		0.00	0.00
Totali për periudhën	1	0.00	193.00
Bilanci		0.00	193.00
Totali për periudhën	2	0.00	0.00
Bilanci		0.00	193.00
Totali për periudhën	3	0.00	0.00
Bilanci		0.00	193.00
Totali për periudhën	4	0.00	0.00
Bilanci		0.00	193.00
Totali për periudhën	5	0.00	0.00
Bilanci		0.00	193.00
Totali për periudhën	6	0.00	0.00
Bilanci		0.00	193.00
50504 - TAKSA PËR MATJEN E TOKËS NË TEREN		0.00	511.00
Bilancet e Hapura		0.00	0.00
Totali për periudhën	1	0.00	110.00
Bilanci		0.00	110.00
Totali për periudhën	2	0.00	18.00
Bilanci		0.00	128.00
Totali për periudhën	3	0.00	122.00
Bilanci		0.00	250.00

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Totali për periudhën	4	0.00	220.00
Bilanci		0.00	470.00
Totali për periudhën	5	0.00	21.00
Bilanci		0.00	491.00
Totali për periudhën	6	0.00	20.00
Bilanci		0.00	511.00
Totali			23,874.50

2.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë gjashmujorti të parë të vitit 2021
Aktivitetet kryesore Janar-Qershorë 2021	Në pajtim me nenin 17 pika f e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me Plan programin e punës.
Aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Tokës ,Mjedisit dhe pastrimit	DSHPE me dt. 22/04/2021 shënoi 22 Prillin - Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe më datën 05/06/2020 Ditën Botërore të Mjedisit. Në këto dy ditë mjedisore janë realizuar aktivitete të rëndësishme si: - Pastrimi i hapsirave publike në Qender të qytetit; - Mbjellja e 4526 luleve; - Mbjellja e Drunjëve dokrativ në sheshin “Fehmi Lladrovci” dhe në parkun e qytetit, - Largimi i disa deponive ilegale;
Aktivitetet në fushën e menaxhimit të mbeturinave	Për të arritur objektivat Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, përkatësisht aktivitete që janë të parapara në këtë plan janë realizuar këto aktivitete: 1. Pas bashkëfinancimit nga komuna e Drenasit dhe mbështetur nga bashkëpunimi Gjerman për zhvillim - GIZ, komuna e Drenasit e cila ka përfituar projektin “Kompostimi Shtëpiak” në sasi prej 326 shportave (komposterëve) për ndarjen e mbeturinave organike, ku përmesë këtij projekti për kompostim shtëpiak në bashkëpunim me ekonomitë familjare i cili ka siguruar parakushte për qytetarë për ndarje të mbetjeve organike përmes ofrimit të komposterit si infrastrukturë, zvogëlim i koston së deponimit të mbeturinave përmes zvogëlimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në deponi, profit ekonomik përmes prodhimit të plehut organik prej ndarjes së mbetjeve për kompostim për nevoja individuale dhe ngritje të vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve si resurs për përfitim, dhe të njejtat janë shpërndar në Drenasin II, si Pilot projekt. 2. Ka vazhduar procesi i shpërndarjes së shportave dhe rritja e numrit të klinetëve që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave është duke vazhduar nga KRM”PASTRIMI” me bashkëveprim me inspektotin e Mjedisit. Ky process në vazhdimësi është duke u realizuar dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve në gjatë këtij gjashmujori janë duke hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe shumë ekonomi familjare, dhe biznese. Për ta arritur qëllimin, jemi duke bashkpunuar me Drejtoratin e Inspektoriatit.

Aktivitetet në realizimin e projekteve kapitale	Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore: • Hartimi i deklarave të nevojës për projektet e DSHPE-së, • Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve , • Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt, • Hartimi i paramasave dhe parallogarive , • Caktimi i organeve për mbikqyrjen e projekteve, • Faza e implementimit të projekteve, • Faza e pranimit teknik të projekteve. Gjate këtij gjashtë muaji janë realizuar projektet një vjeqare dhe ato që janë me kontratë kornizë, të cilat po i paraqesim si me poshtë. • Rregullimi i rrethojave të varrezave në Komunën e Drenasit Për këtë projekt janë kryer procedurat e prokurimit publik dhe janë duke u bërë rregullimi i varrezave në fshatin Kizharek, ndersa nga mbetja e mjeteve nga kontrata e parë është dërguar për prokurim të re dhe faza e dytë e rregullimit të rrethojës së varrezave në fshatin Sankoc- Lagja Lika; • Rehabilitimi i gropave në rrugët e asfaltuara- (kontratë kornizë), Është kryer hartimi i paramasave dhe parallogarive dhe njihërit është kryer edhe procedura e prokurimit publik dhe janë caktuar vendet për rregullim të gropave në rrugët e asfaltuara, dhe kompania do të fillojë në realizim të projekteve. • Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre: Është hartuar paramasa dhe parallogaria dhe është zhvilluar procedura e prokurimit publik për 11 vendndalje (stacione të autobusve), si në: Terstenik, Vërboc, Nekoc, Dobroshec, Fushticë e Ultë, Zabel I Eperem, Baicë, Gjergjicë, Poterrk, Damanek , Krojkovë, ku janë në fazën e implementimit nga OE. • Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit: Është bërë rregullimi i defekteve për 25 kamerat e qytetit, të cilat janë dal jashtë sistemit dhe tani më janë në funksion. Po ashtu janë vendosur edhe disa kamera Mobile në disa lokacione ku komuna e ka parë të arsyshme se bashku me Policinë dhe njihërit i janë dhënë 5 kamera mobile në shfrytëzim për nevojat e sigurisë publike, stacionit të policisë në Drenas. • Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriqimit Publik: (kontratë kornizë), ky projekt është duke u realizuar duke e bërë mirëmbajtja e ndriqimit publik në vazhdimësi, kryesisht kemi të bëjmë me ndërrimin e trupave ndriques, ngjyrosjen e shtyllave të ndriqimit, lidhjen e kablove aty ku po ka dëmtime, ndërrim të kontaktorve, fotoqelulave etj. • Blerja e kontejnerve dhe shportave për mbeturina: Te ky projekt është duke u përgaditur hartimi i paramasave dhe parallogarisë për furnizimin me dy lloje të kontejnerve dhe atë: 120 l dhe 240 l, dhe që janë të nevojshëm për shtrirjen e shërbimit në të gjitha ekonominë familjare dhe bizneset gjatë procesit të zgjerimit. • Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontratë Kornizë): Janë kryer procedurat e prokurimit publik dhe është duke u realizuar projekti i shenjëzimit vertikal dhe horizontal në të gjitha vendet ku kemi pasur kërkesa si: Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qendër të qytetit, parkingjeve, shenjëzimi vertikal për vendndalje të autobusve, shenjëzimi horizontal në stacionin e autobusëve, kompletimi me shenjëzim vertikal tek rrugët ku atakohen me hekurudhën, shenjëzimi horizontal dhe vertikal i zebraeve në rrugët në qendër të Drenasit, dhe vendbanime tjera ku ka qenë e nevojshme, sidomos në rrugët që janë në afërsi të shkollave, si dhe është bërë vendosja e laurës në parkingun e Bllokut të V –të në rrugën “Adem Mulaj” dhe janë dhënë edhe kartelat për hyrje dalje për të gjithë banorët e bllokut të V-st dhe bllokut të IV-të,
---	--

- **Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore** për vitin 2020- 2021. Projekti ka filluar sipas sezonës dimore dhe ka përfunduar sipas kontratës. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira për mirëmbajtje dhe pastrim nga bora rrethë 530 km rrugë dhe 26,405 m², sipërfaqe me parkingje, Sheshe dhe trotuarë, dhe është e lidhur kontrata kornizë për tri vitet në vazhdim me kompanin “PASTRIMI”
- **Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës (projekt kornizë)** - kontrata përfundon në fund të këtij muaji dhe ne kemi hartuar paramasen dhe parallogarin dhe e kemi proceduar për zyren e prokurimit për zhvillimin e proceduraeve, ndersa menagjert e projektit janë duke hartuar raportet për përfundim të kësaj kontrate.
- **Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike(kontrat kornizë:** Ky projekt është duke u implementuar në gjithë teritorin e Komunës, në bazë të kërkesave të ardhura nga administratoret e fshatrave, dhe detyrës zyrtare që është e paraparë me ligjë për mirëmbajtje të ambientit (kanalizimeve atmosferike, fekale dhe gropave septike), të cilat po kryhen në mënyren më të mirë të mundëshme duke zhblllokuar kanalizimet të cilat me vite kanë qenë të pazgjidhura. Në këtë rastë janë bërë debllokime të kanalizime me gypa duke filluar nga ata Ø200, 250, 315 dhe 400 (mm), dhe pastrimii gropave septike dhe kanalizimit atmosferik, vendosjen e kapave metalik dhe atyre të betonit etj.
- **Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavor**-Ky projekt ka qenë me kontrat kornizë edhe për këtë vitë, por për shkak të nevojave të tërenit si rezultat i vërshimeve që kanë ndodhur në muajt Janar dhe Shkurt është dashur të intervenohet me furnizim me zhavor , andaj janë shpenzuar sasit e zhavorit dhe është mbyllur kontrata, dhe njiherti i kemi hartuar paramasen e re dhe janë duke u zhvilluar procedurat e prokurimit public, dhe pas përfundimit dhe zgjedhjes se operatorit ekonomik , atëher ne do të vazhdojm me mirmbatjën e rrugëve me zhavor.
- **Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë):** Ky projekt është duke u implementuar sipas paramasës dhe parallogarisë dhe njiherti është duke vazhduar me punët si: Pastrimi, fshirja dhe larja e Sheshit, kositja e barit, prashitja e drunjeve dekorativ, plehrimi, largimi I mbeturinve, krasitja dhe mbjellja e luleve.
- **Projekti i eliminimit të deponive ilegale**, ky projekt është duke implemtuar në dy faza dhe janë eliminuar deponit e egra sipas lokacioneve që janë identifikuar nga GIZ-I dhe zyrtaret komunal. Gjatë këtij gjashtmuajori është realizuar identifikimi i deponive ilegale për vitin 2021 nga zytari komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektori komunal mjedisor në bashkëpunim me Giz/in. Gjatë këtij procesi është bërë identifikimi i 24 deponive ilegale në komunën e prej gjithësej 24 deponive ilegale të identifikuara 8 prej tyre janë të vogla, 3 të mesme dhe 13 të mëdha. Dhe janë në fazën e implementimit nga OE.
- **Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik;**

Janë hartauar paramasat dh dhe janë përcjellur për procedura të prokurimit public, por sipas infmatave qe kemi lënda ka kaluar në OSHP, për shkak të disa ankesave , andaj , kjo është duke u mirëmbajtur në kudër të projektit për eleminimin e deponive ilegale, deri në marrjen e përgjegjjes nga ana e OSHP.
- **Projekti për Intervenimet Emergjente:** (kontratë kornizë), ky projekt është nenshkuar kontrata dhe ka filluar implementimi në terën sipas kërkesave të adresuar nga qytetarët, si largimin e kafshëve të ngordhura dhe gropsjen e tyre, vendosja e lëshesavenë fytet e ngushta, dhe do të bëhët edhe dezinfektimi i hapsirave publike në Qytetin e Drenasit dhe Komoran.

	• Trajtimi i qenve endacak në komunën e Drenasit: Është hartuar paramasa dhe parallogaria dhe është dërguar për procedurë të prokurimit publik, dhe do të impletohet sipas standardeve dhe rregulloreve që janë në fuqi. • Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit: ky projekt është duke u implementuar në bazë të shënimeve të sjellura nga Bashkësia Islame për shërbimet e kryera. • Efiqencia e Energjisë: Pas aplikimit të komunës për 10 projekte në Fondin e Kosovës për Efiqencë të Energjisë të cilat projekte janë në listen e Planit komunal të Veprimit për Efiqencë të Energjisë, ka filluar implementimi i 5 projekteve, fillimisht në hartimin e Raporteve të audutimit të Energjisë dhe zgjidhjes së skenarëve që janë të implementueshëm për zbatim, ndërsa të 5 tprojekte tjera pritet që të fillojnë në fund të muajit korrik, në mënyrë që të arrihen caqet e kursimeve të energjisë për këto objekte.
Ndarja e subvencioneve	▪ Subvencione dhe Transfere: Pas vërsimeve që ndoshen në komunë e Drenasit në Muajt janar dhe Shkurt, u shaktuan shumë dëme në Objekte banimi, biznese, infrastruktur dhe bujqësi, ku për këtë qëllim Kryetari I komunës ka formuar tri komisione për vlerësimin e dëmeve, ku këto komisione kanë dalur në tërën dhe kanë vlerësuar dëmet e shaktuara dhe njiherti kanë hartuar edhe raportet për secilin rastë veq e veq, dhe njiherti janë përcjellur në Ministrinë Pushtetit Lokal për mundësin e kompenzimit të dëmeve. Në Muajin Mars na është konfirmuar se për komunën e Drenasit janë ndarë 68,000.00€ për kompenzim të dëmeve vetëm në objekte banimi, dhe ne si Drejtoarat në bashkupim me zyren e kryetarit kemi hartuar vendimet për kompenzim të dëmeve për 87 Ekonomi familjare (objekte banimi), dhe të njëjtat janë realizuar për pagesë. Po ashtu nga komisioni komunal i caktuar nga zyra e kryetarit janë duke bërë edhe vlerësimet e dëmeve për rastet që po ndodhin për shak të zjarreve etj.
Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave	Gjatë periudhës gjashtë mujore në adresë të DSHPE-së janë pranuar këto kërkesa: - 388 – kërkesa të ndryshme siq janë: - kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajtuar të gjitha. - kërkesa për shenjzim horizontal dhe vertikal të komunikacionit, - kërkesa për zhavor për rrugët e rendit të IV, - kërkesa për renovimin e gropave të asfaltit , - kërkesa për zgjerim të ndriqimit publik, - kërkesa për parkingje të rezervuara, - kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave, - kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza, - kërkesa për kompenzim të dëmeve nga FNFT dhe - kërkesa të natyrave tjera të ndryshme. - Kërkesë për furnizim me ujë higjienik • Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe sipas detyrës zyrtare ato që kanë qenë të realizueshme kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër ose është refuzuar ose është ende në process për shkak të mungesës së bugetit, mirëpo u është kthyer përgjigje palëve.
Menaxhimi i Stacionit të Autobusve dhe parkingjeve publike	DSHPE-ja në bazë të Vendimit 01 Nr. 344-8563 prej dt. 16/02/2016, ka në Menaxhim Stacionin e Autobusve me objekte përcjellëse në Glllogoc, deri sa të definohet statusi i tij. Pagesa e tarifave në emer të kryerjes së shërbimeve për peronizim, provision nga Operatorët Ekonomik bëhen në lartësi të tarifës së shërbimeve që janë përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë për Stacionet e Autobusve të kategorisë së dytë, mirëpo këtë vit për shkak të pandemisë janë respektuar vendimet e

	marrura nga niveli qendror dhe për pagesat për peronizim janë liruar Operatoret e transportit public të udhëtareve me autobus.
Takimet zyrtare	• Takim me organet kompetente që mundë të kontribojnë, me qëllim të bashkëpunimit në mbarëvajtjen e punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike • Takime me përfaqësuesit e organizatës së Giz-it (takime online,për qështje të komposterve), • Takim me Asociacionin e Komunave të Kosovës,(takime online, në form virtuale) • Takim me agjencionin e Emërgjencave-AME, (takime online, ne form virtuale) • Takim me strukturat e KEDS-it, • Takime me administratorët e fshatrave, me biznese, me qytetar rreth menaxhimit të mbeturinave, ndarjes dhe zgjerimit të shërbimit, furnizim me ujë pijshëm.

2.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Zyrtarët nga Drejtoria për Infrastrukturë Publike, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në plan programin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Në bazë të detyrave që janë realizuar gjatë pjesës së parë të vitit 2021, zyrtarët përgjegjës kanë përgatitur këtë:

I. Raport i punës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2021

Drejtorja për Infrastrukturë Publike, së bashku me punëtorët e kësaj Drejtorie është i angazhuar në projektet, e infrastrukturës rrugore, në projektet për: rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimin e ujësjellësit, trotuareve, ndriçimit publik, rregullimi dhe pastrimi i lumenjve, projektet për trajtimin e kolektorëve të ujërave të zeza si dhe projekte tjera.

II. Aktivitetet e zhvilluara nga Drejtoria për Infrastrukturë Publike

Përpilimi i kërkesave të investimeve kapitale, deklarata e nevojave për publikimin e projekteve kapitale, specifikacionet teknike për projektet e DIP.

Aplikimi në ministri të ndryshme për përfitimin e projekteve kapitale në interes të Komunës.

Përpilimi i njoftimeve për palët në përgjigjet e kërkesave.

Hapja dhe vlerësimi i ofertave për tenderë

Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratave të investimeve kapitale.

Pranimi teknik i projekteve të realizuara në teren

Takime me ministri të ndryshme rreth projekteve kapitale dhe përpilimi i marrëveshjeve të memorandumëve të mirëkuptimit.

Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorët

Plotësimi i formularëve për performancë komunale

Përpilimi i buxhetit për investime kapitale korniza buxhetore 2022-2023-2024.

Aktivitetet e mbikëqyrjes së punimeve edhe mbas orarit zyrtar dhe ditëve të shtune nga punëtorët e drejtorisë së Infrastrukturës Publike.

Punët më palë.

Realizimi i projekteve të cilat janë në vazhdimësi:

-Rregullim i kanalizimeve në gjatësi ~ 33400m'

-Rehabilitim i kanalizimeve kontrata të lidhura 24000m'

-Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza 3500m’

-Ndërtimi i rrugëve më asfalt ~22500’

-Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Komunën e Drenasit 11175m’, po ashtu vendosja e ujëmatësve në fshatrat Çikatovë e Vjetër, Godanc, Gllanasellë. Ku vlen të ceket se rrjeti prej rezervuarit të Feronikelit deri tek STP në Çikatovë të Vjetër dhe furnizimi më ujë për banorët e këtyre fshatrave mbetet vetëm në menaxhimin e K.R.U. Ujësjellësit NJO-UK Drenas.

-Në ndërtimin e ujësjellësit është duke punuar edhe “CDI “ në vlerë 483,975.33€, duke rregulluar rrjetin në qendër të qytetit të Drenasit, po ashtu rrjetin nga rrethi në Drenas deri në Komoran për furnizim të këtyre fshatrave në të dy anët e rrugës regjionale R-102. Në këtë projekt është duke u realizuar edhe STP(stacioni i pompave) tek xhamia në Drenas.

-Rregullimi i trotuarit në gjatësi ~9300m’, ndersa pjesa tjetër e projektit është në vazhdim duke u realizuar

-Rregullimi i ndriçimit publik pjesa e realizuar në vitin 2021 është 46000m’, pjesa tjetër e projektit është në realizim

-Pastrimi i lumenjve është duke vazhduar në disa fshatra nga projekti i vitit 2020 i cili ishte projekt dy vjeçar Përpilimi i rishikimit të buxhetit dhe propozimi me bartje të buxhetit për vitin 2021

Gjatë periudhës janar-gusht janë dërguar gjithsej 430 kërkesa ku 312 prej tyre janë kthyer përgjigjet ndërsa 118 prej tyre janë në proces.

III. Projektet me ministri të ndryshme dhe zhvillimi i aktiviteteve

1. Asfaltimi i Rrugës Tërdec-Vuçak në bashkëpunim me Ministrin e Infrastrukturës në vlerë prej 328,641.15€ (projekt tre vjeçar)
2. Ndërtimi i Rrugës Gradicë-Zhilivodë në vlerë financiare projekt i financuar nga MIT punët janë duke vazhduar krahas buxhetit.
3. Ndërtimi i Rrugës Transit Drenas, janë duke u zhvilluar punimet
4. Ndërtimi i Rrugës së re Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës me MIT në vlerë financiare 600,000.00€ Vazhdon punimet në vitin 2021
5. Ndërtimi i Infrastrukturës në Komoran –me MIT në vlerë financiare ku ka mbetur të përfundohet vetëm rreth rrotullimi në Komoran.

IV. Vështirësitë rreth punëve në zyrë dhe teren

Mungesa e stafit dhe numri i vogël i punëtorëve në DIP, ku aktualisht në drejtorin në fjalë janë një sfidë pasi ne. Ndërsa volumi i projekteve është tejet i madh dhe punëtorët janë të stërngarkuar me punë. Problemet në teren janë të natyrave të ndryshme si duke u nisur nga pengesat e banorëve në lidhje me kontestet pronësore si dhe problemet tjera me operatorët ekonomik.

Sfidë kryesore mbetet çmimi ekonomikisht më i lirë i vlerësuar nga zyra e prokurimit e cila e ulë çmimin e cilësisë së punëve dhe kualitetin e punimeve. Marrja e mjeteve financiare në mënyrë të dhunshme për lëndë të kontesteve të gjykatave dhe noterët nga projektet kapitale ku prish qelizën e zhvillimit të projekteve kapitale. Po ashtu edhe dhënia e shumë kontratave për punë për një kompani punëkryese. Alokimi i buxhetit është bërë në muajin Qershor.

V. Zhvillimi i aktiviteteve të projekteve kapitale në formën tabelare të financuar nga buxheti i komunës në vlerë 2,335,589.00 € ; grande qeveritare në vlerë financiare 1,655,589.00€ ndërsa të hyra vetanke 680,000.00€ .

2.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021 (01.01.2021-30.06.2021) në kuadër të fushë veprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2021. Punës/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimi dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës së Drenasit, krijimin e kushteve sa më favorshme ,infrastrukturë dhe mjedisi sa më të përshtatshëm për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme për një zhvillim sa më të qëndrueshëm. Fokus të veçantë vazhdon t'i kushtohet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizmit, zbutjes së papunësisë, duke mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës. Pra, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes, promovimin e komunës së Drenasit si një Komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithmonë e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmonë duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

PËRMBLEDHJE:

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Pajisje me certifikata të reja me Numër Unifikues;
- Pajisja me informata shitesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore dhe mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Lirimi nga Taksa në Biznese për vitin 2021 për shkak të pandemisë, i propozuar nga Kryetari i Komunës dhe i miratuar në Kuvendin Komunal;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjashme;
- Bartja e të dhënave në mënyrë manuale nga programi i vjetër i taksës komunale në programin e ri E-Taksa.
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat);
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe
- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

Sipas zyrës për biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2021 deri me datën 30.06.2021 janë të regjistruara **108** biznese të reja, krahasuar me vitin paraprak të njëjtës periudhë që ishin regjistruar **88** biznese ose shprehur në përqindje **22.72%** më shumë se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **162** punëtorë. Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikues të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa më të volitshëm për regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2021 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

I. Tabela e klasifikimit të bizneseve të punësuarve regjistruara në periudhën: 01.01.2021 – 30.06.2021

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	62	57.40%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	46	42.60%
Të mëdha	60 - e më tepër	-	-
Gjithsejtë:		108	100.00%

II. Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2021 – 30.06.2021 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (57.00%).

Nr .	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregëti	35	32.41%
2.	Transport	1	0.92%
3.	Ndërtimtari	22	20.38%
4.	Hoteleri	19	17.60%
5.	Bujqësia	5	4.63%
6.	Sallone Ondulimi	8	7.40
7.	Industri- zëjtari prodhuese	17	15.74-
8.	Arsim	1	0.92%
	Gjithsejtë:	108	100.00 %

III. Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën 01.01.2021 – 30.06.2021

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	62	57.40%
2	Ortakëri e përgjithshme	/	
3	Ortakëri e kufizuar	/	
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	46	42.60%
5	Shoqëri Aksionare	/	
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj	/	
7	Ndërmarrje publike	/	
8	Kooperativë bujqësore	/	
	TOTALI:	108	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2021 – 30.06.2021 në Komunën e Drenasit, Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 57.40% dhe 42.60% Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar, regjistrimi i tipit të biznesit SHPK. Edhe këtë këtë periudhë ka treguar

një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë periudhës 01.01.2021 – 30.06.2021, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: **60** ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën paraprake të vitit të kaluar bizneset që patën ndryshime ishte **65 biznese ose 8.3%** ma pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe sipas muajve dukën kështu:

IV. Ndryshime në biznes sipas periudhës: 01.01.2021 – 30.06.2021;

Nr.	Muajt e vitit	I	II	III	IV	V	VI						
1.	Ndryshimet në biznese	10	7	16	16	4	7						

V. Punë/ shërbime tjera, gjatë periudhës: 01.01.2020 – 30.06.2020;

Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali:
1	Shuarje të bizneseve	12
	Çertifikata të reja për biznese fillestare	108
	Çertifikata të ripërtërira	39
	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore.	28
2	Pagesa të Taksës për Biznes sipas faturimit.	3676.5 €

➤ **Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në:**

- Pjesëmarrje në punëtori “Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve” e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrja në trajnimin “Lidershipi dhe Menaxhimi i Administratës Lokale” të organizuar nga IKAP;
- Pjesëmarrja në seminarin e organizuar në mënyrë virtuale me temë: “ Analiza për investime Kapitale e realizuar sipas rajoneve Zhvillimore të vitit 2019 “ e organizuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale(KLGI) dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Pjesëmarrja në takimin/punëtorinë e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me RCDN “Principi i punës së Impianteve për trajtimin e Ujërave të Zeza në Kosovë. Korniza Ligjore dhe skema e proceseve të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Pjesëmarrja ne tryezën Ndikimi i COVID-19 në Turizmin në Kosovë”, organizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë’
- Pjesëmarrja në tryezën -Ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimi për projektet dhe aktivitetet në turizëm ,organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e

- përkrahjes/financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit;
- Takim i Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për vitin 2021 me qëllim diskutimin e temave aktuale në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë të Kolegjiumit, në harmonizimin e veprimtarisë dhe koordinimin e aktiviteteve të strukturave të AKK-së për vitin 2021.
 - Takim me përfaqësuesit e WOMEN 4 WOMEN, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit për përkrahjen e grave në bujqësi dhe hortikulturë;
 - Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve ku janë diskutuar për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore;
 - Janë realizuar takime me përfaqësuesit e shoqatave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale të Komunës së Drenasit;
 - Takim me udhëheqësen e Departamentit për Zhvillimin e Politikave Industriale, Igballe Rexha-Jasharin dhe zyrtarët Muhamet Hashani e Nystret Vojvoda në kuadër të Divizionit për Politika Industriale në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vizitë tek bizneset prodhuese
 - Takim me Drejtorin e Socio-Projekt Kosova, Valentin Hoxha për mundësinë e bashkëpunimit
 - **Arritja e marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV**
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me AZHER-Qender
- **Projektet të cilat janë duke u implementuar :**
 - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Women 4 Women në projektin “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE që financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) me fondet e Koorporatës Austriake për Zhvillim (ADC), parasheh që për bizneset e grave të ndajë grante me shumë deri në 3,500.00€.
 - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHRQ). ka lansuar skema e granteve “Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë”.
 - Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyre të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësin e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privatë/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si;
 - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka njoftuar të gjitha subjektet biznesore (barnatoret), se DZHE ka hartuar orarin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare, për subjektet afariste që janë furnizues të përditshëm për qytetarët me barëra;
 - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vizituar bizneset prodhuese;

- Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik/Drejtoresha ka vizituar disa nga bizneset të cilat janë dëmtuar nga vërshimet në disa zona ku për pasojë ata janë dëmtuar në masë të konsiderueshme në produktet e tyre;
- Thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NMVM lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA);
- Thirrje për aplikim për skemën grate ndërmarrëse lidhur me programin për grante - Gratë Ndërmarrëse në Energji (ĒEE) thirrje për aplikim nga Fondacioni Mileniumit i Kosovës (MFK);
- Thirrjen për trajnime online për biznese në fushën e menaxhimit të financave nga MZHR dhe BERZH;
- Thirrje për aplikim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet NMVM sipas kategorive të tyre;
- Thirrje për aplikim për skemën e garantëve nga Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar PZHRB 2021” (lot 1 Start –up dhe lot 1 biznes ekzistues) si dhe “Skemën e Garantëve Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021”, Masa 15 (lot II dhe lot III);
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHR) ka mbajtur trajnim për nxënësit, studentët dhe gjithë të interesuarit në kuadër të projektit “Trajnimi profesional dhe angazhimi në punësim” “Trajnim për Orientimin në Karrierë / Trajnim për aftësi të buta” të organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- **Zhvillimi dhe promovimi i turizmit**
 - Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës;
 - Përzgjedhja e atraksioneve turistike në bashkëpunim me DRKS - atraksion turistik është një vend për të cilin interesohen turistët, zakonisht për vlerën natyrore ose kulturore, rëndësinë historike, bukurinë natyrore ose të ndërtuar, duke ofruar kohë të lirë dhe zbavitje.

Gjendja e pandemisë e shkaktuar nga Covid-19 ka ndikuar në shumë procese/projekte kanë mbetur pa u implementuar gjatë periudhës së parë të këtij viti në mungesë donacioneve (01.01.2021-30.06.2021).

KRYETARI I KOMUNËS

RAMIZ LLADROVCI

